



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17/2019 regjistër (JR)
Datë 04.04.2019

Nr. 9 i vendimit
Datë 26.06.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Ardian Hajdari	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Luan Daci	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 26.06.2020, ditën e premte, në orën 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Alfred Gjoni, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

OBJEKTI I ANKIMIT: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 100, datë 14.01.2019.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe parashtrimet, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Alfred Gjoni, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Alfred Gjoni (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse të procesit: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve të tij dhe vlerësimit të të dhënave të tjera të përcjella prej agjencive ligjzbatuese, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kriterëve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar² në vijimësi, ku ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit.

1.3 KLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar tri dokumente ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi dhe të dorëzuara prej tij, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumente të tjera ligjore që i përkasin periudhës së rivlerësimit, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm në dy kriteret e rivlerësimit, përkatësisht në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe atij të aftësive profesionale dhe,

¹Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.01.2018.

²Më parë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, është përcjellë pranë Komisionit raporti fillestar për kontrollin e figurës së Alfred N. Gjoni, me konstatimin për përshtatshmëri në vijimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.

³Raporti i KLD-së, i dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 07.05.2018.

në përfundim të procedurës administrative, ka marrë për subjektin e rivlerësimit, vendimin nr. 100, datë 14.01.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 100, datë 14.01.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke u mbështetur në konkluzionet e mëposhtme.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

1. Për apartamentin e banimit me sipërfaqe 60 m², me nr. pasurie {***}, Zona Kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}, ndodhur në rr. “{***}”, subjekti i rivlerësimit:

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1.154.846 lekë për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit;
- ka kryer deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti;
- ka mospërputhje deklarimesh gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet për mobilimin e këtij apartamenti.

2. Për apartamentin e banimit me sipërfaqe 47,74 m², me nr. pasurie {***}, Zona Kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}, ndodhur në rr. “{***}”, legalizuar me lejen e ndërtimit nr. {***}, datë 23.04.2013, me numër serial {***}, subjekti i rivlerësimit:

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës;
- ka kryer deklarim të rremë në deklaratën “vetting” në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti;
- ka kryer deklarim të rremë në deklaratën “vetting” në lidhje me vitin e ndërtimit të këtij apartamenti;
- i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti.

3. Në lidhje me likuiditet, subjekti i rivlerësimit:

- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për shlyerjen e kredisë së marrë në Raiffeisen Bank;
- nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting”, por dhe në asnjë nga deklaratat periodike të interesave privatë, huan e dhënë z. E.Ç. dhe nuk provon me dokumentacion provues kthimin e huas nga z. E.Ç.;
- ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për dhënien e huas z. E.Ç.

4. Në lidhje me pasuritë e padeklaruara, ato në përdorim dhe të dhuruara, subjekti i rivlerësimit:

- nuk ka deklaruar në deklaratën “vetting” pjesën takuese të bashkëshortes së tij prej {***} të një apartamenti me sipërfaqe 83 m², ndodhur në Bulqizë;
- ka fshehur posedimin dhe përdorimin e një apartamenti në qytetin e Durrësit;
- ka në pronësi të fshehur një apartament në qytetin e Durrësit;
- nuk ka deklaruar të drejtën e përdorimit të tri automjeteve në deklaratën “Vetting”.

5. Në lidhje me deklarimet në pyetësin standard dhe të dhënat e TIMS dhe AMF, subjekti i rivlerësimit:

- ka dhënë deklarim të rremë përpara Komisionit në lidhje me udhëtimin e tij në Bruksel;

- ka dhënë deklarime të rreme përpara Komisionit në lidhje me gjykimin e çështjeve gjyqësore me palë z. L.N.;
- në vendimin nr. {***}, datë 28.05.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka përfshirë në dispozitivin e vendimit, në rrethin e trashëgimtarëve, z. A.N., i cili rezulton të ketë qenë i vdekur, si dhe nuk është shprehur në lidhje me statusin civil të z. A.N. apo të faktit nëse ai ka pasur fëmijë;
- ka dhënë deklarime të rreme në lidhje me z. I.D. pasi, bazuar në deklaratimet e tij, ai ka gjykuar çështje gjyqësore ku ky shtetas ka qenë përfaqësues i palëve.

3.2. Për vlerësimin e aftësive profesionale:

1. *Komisioni çmon se të metat e konstatuara në shqyrtimin e dosjeve gjyqësore të trajtuara më sipër, reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen: zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, mënyra jo korrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, që merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016*

2. Komisioni, pas shqyrtimit përfundimtar të çështjes, ka arritur në përfundimin se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, ka reflektuar mangësi të tilla në kriterin profesional që nuk mund plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe, për këto arsye, Komisioni, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit Alfred Gjoni, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

III. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit, më datë 28.03.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 100, datë 14.01.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 100/1, datë 01.04.2019.
5. Me ankimin dhe parashtrimet, subjekti i rivlerësimit Alfred Gjoni kërkon nga Kolegji riçeljen e hetimit gjyqësor për vlerësimin e provave të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, pranimin e shpjegimeve të tij, duke vendosur ndryshimin e vendimit nr. 100, datë 14.01.2019, të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.
6. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit Alfred Gjoni ndaj vendimit të Komisionit nr. 100, datë 14.01.2019, si shkaqe të ankimit janë evidentuar sa më poshtë vijon.

A. Mbi procesin e rregullt ligjor, si dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit e të formës së vendimit të Komisionit.

6.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se procesi i zhvilluar nga Komisioni është zhvilluar në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor, pasi hetimi i kryer ka qenë i njëanshëm dhe i realizuar në kundërshti të plotë me normat procedurale e në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi nuk kanë gjetur respektim të plotë në procesin dhe në vendimmarrjen e Komisionit: (i) parimi i ligjshmërisë; (ii) parimi i drejtësisë dhe paanësisë; (iii) parimi i barazisë

para ligjit; (iv) parimi i mbrojtjes juridike dhe të lirive dhe të drejtave Kushtetuese; (v) parimi i proporcionalitetit; (vi) parimi për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor.

6.2 Zhvillimi i procesit hetimor vetëm për dy kritere, përkatësisht për kontrollin e pasurisë dhe vlerësimin e aftësive profesionale, ka sjellë shkeljen e parimeve ligjore të shprehura qartë në Kushtetutë dhe në ligjin e posaçëm.

6.3 Lidhur me aspektin procedural të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni, subjekti pretendon se Komisioni:

- (i) kishte detyrim ligjor të kryente një hetim të pavarur dhe të merrte vetë prova, me qëllim arritjen e një konkluzioni për dhënien ose jo të masës disiplinore, dhe jo të luante një rol pasiv;
- (ii) pas kalimit të barrës së provës nuk bëri me dije se cilat nga provat e shpjegimet e dhëna u pranuan dhe cilat jo dhe arsyet përkatëse të mospranimit të tyre;
- (iii) kreu seancën dëgjimore publike pa kryer vlerësimin e shpjegimeve të subjektit dhe të provave të paraqitura me to pas kalimit të barrës së provës, si dhe pa i bërë me dije rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës;
- (iv) lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pa i kaluar barrën e provës sipas ligjit të KLD-së për disa nga gjetjet e KLD-së, ka arritur në një konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale të ndryshëm nga ai i KLD-së i bërë për të.

6.4 Vendimi i dhënë nuk është në përputhje me standardin strukturor që parashikon neni 310, paragrafi II, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, për shkak të mungesës së dispozitave ligjore dhe renditjes së çështjeve jo sipas asaj që përmbanin rezultatet e hetimit.

B. Mbi kontrollin e kriterit të pasurisë:

6.5 Subjekti i rivlerësimit pretendon se ai nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe se e ka deklaruar saktë atë, pasi:

- (i) akti i ekspertimit kontabël i sjellë në cilësinë e provës prej tij, për të ardhurat neto të tij dhe të familjes së origjinës për periudhën 1995-2016, konfirmon se subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurive;
- (ii) akti i ekspertes për vlerësimin e pronës apartament banimi dhe shtesë anësore në Tiranë, konkludon se vlera e saj është e njëjtë me atë që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka shpenzuar për blerjen e apartamentit dhe ndërtimin e shtesës;
- (iii) subjekti nuk ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për shlyerjen e kredisë së marrë në vitin 2005 pranë Bankës Raiffeisen, të shlyer në vitin 2007;
- (iv) në vitin 2009 nuk ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për dhënien e borxhit shtetasit E.Ç.

6.6 Qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për banesën në Durrës, i cili e ka konsideruar atë si pasuri të fshehur të subjektit, duke e regjistruar në emër të personave të tretë, subjekti i rivlerësimit nuk e konsideron të drejtë pasi pretendon se gjatë hetimit administrativ, ka arritur të provojë se kushëriri i tij, z. H.Gj., ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti.

6.7 Gjithashtu, edhe qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për banesën në Bulqizë, për të cilën Komisioni ka konkluduar se subjekti ka fshehur pronësinë mbi një pjesë të saj nga bashkëshortja, subjekti i rivlerësimit e konsideron jo të drejtë pasi, sipas tij, kjo banesë/apartament është në përdorim e posedim të vëllait të bashkëshortes së tij, e cila nuk ka pasur dijeni e as ka pretendim për pjesën takuese mbi këtë pronë.

6.8 Për automjetet në përdorim të subjektit të rivlerësimit, të konstatuara gjatë hetimit administrativ, subjekti pretendon se i ka përdorur në udhëtimet jashtë vendit dhe se në të gjitha rastet ato kanë qenë në përdorim të tij për atë udhëtim konkret, duke pretenduar se mosdeklarimi i tyre në deklaratat periodike dhe atë *vetting*, përbën harresë njerëzore e cila nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim.

6.9 Sipas subjektit, pasaktësitë në deklaratën e deklarimit të pasurisë të plotësuar në kuadër rivlerësimit, të njohur si deklarata “*vetting*”, referuar vetë shpjegimeve të dhëna në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, përjashtojnë shkarkimin automatikisht të subjektit për shkak të pasaktësive, por vendosin organet e rivlerësimit para detyrimit për të analizuar në mënyrë diskrecionale nëse jemi para një sjelljeje të qëllimshme për të fshehur pasurinë apo para një pasaktësie në plotësimin e deklaratës *vetting*, si dhe për t’i vlerësuar ato në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

C. Mbi kontrollin e kriterit të aftësive profesionale:

6.10 Subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për vlerësimin e aftësive profesionale duke pretenduar se:

(i) Nuk mund të konsiderohet si shkak shkarkimi vonesa në trajtimin e çështjeve dhe arsyetimin e vendimeve, pasi kjo duhet parë e vlerësuar në raport me ngarkesën e punës së subjektit të rivlerësimit, si dhe duke konsideruar se edhe vetë Komisioni në arsyetimin e vendimit objekt ankimi nr. 100, datë 14.01.2019, ka tejkalluar afatin ligjor njëmuor të parashikuar për arsyetimin e tij.

(ii) Arsyetimi i Komisionit lidhur me cilësimin e gabuar të çështjes me të pandehur shtetasin G.D. dhe lidhja që trupi gjykues i Komisionit i ka bërë kësaj çështjeje me pyetjet e shtruara në seancën dëgjimore publike, e përgjigjet e dhëna, janë absolutisht irracionale dhe joligjore.

Ç. Mbi konkluzionin për cenimin e besimit të publikut:

6.11 Subjekti pretendon se konkluzioni i vendimit të Komisionit për cenim të besimit të publikut, është i pabazuar, pasi arritja e një konkluzioni të tillë duhet të jetë detyruesisht e lidhur me veprime apo sjellje që konsiderohen se përbëjnë shkelje të normave ligjore në fuqi.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

7. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 100, datë 14.01.2019, u mor në shqyrtim në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”). Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur me parashtrimet e tij⁴, pas marrjes së njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi.

⁴ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegji parashtrimet me shkrim, të cilat janë protokolluar me nr. {***} prot., datë 19.06.2020, dhe nr. {***} prot., datë 22.06.2020.

7.1 Me parashtrimet e datës 19.06.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me qëllim debatimin e provave në prani të tij, në funksion të ndreqjes së shkeljeve të rënda procedurale e të konstatimit të gjendjes faktike në mënyrë të plotë e të saktë, sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, si edhe në funksion të marrjes në shqyrtim të provave të reja të paraqitura prej tij bashkëlidhur këtyre parashtrimeve.

7.2 Në shqyrtimin e këtij pretendimi të paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstatoi se subjekti ka depozituar bashkëlidhur me parashtrimet e datës 19.06.2020, aktet si më poshtë.

- *Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë nr. {***} prot., datë 14.12.2018.*

- *Formular “Njoftim tatimi”.*

- *Deklaratë, datë 10.01.2001, e bërë nga A.Gj., mbi të ardhurat për periudhën janar-dhjetor 1995, mbi detyrimet fiskale të lokalit “Bufe”.*

- *Licencë për aktivitet “Bufe”, e vitit 1995, për A.Gj.*

- *Kopje e fletës së parë të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor “{***}”, si person fizik me nr. {***}.*

7.3 Nga verifikimi i akteve që gjenden në fashikujt e gjykimit, të krijuara gjatë hetimit administrativ në Komision, Kolegji konstatoi se të gjitha këto akte gjendeshin të administruara në këta fashikuj dhe, për pasojë, asnjë prej tyre nuk plotësonte kërkesat e një prove të re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

7.4 Me të njëjtin arsyetim, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Kolegji, më datë 22.06.2020, parashtrime të tjera, duke kërkuar administrimin me cilësinë e provës së re të dokumentit me nr. {***} prot., datë 23.10.2018, të DSIK-së, nëpërmjet të cilit ky institucion bën vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi rivlerësimi.

7.5 Lidhur me këtë pretendim të subjektit, Kolegji konstaton se përveçse ky dokument, ashtu si edhe aktet e cituara më lart, janë pjesë e fashikujve të gjykimit të kësaj çështjeje, për shkak se janë administruar prej Komisionit gjatë hetimit administrativ, ky raport i DSIK-së, i kërkuar për t’u vlerësuar si provë nga subjekti, citon në konkluzion të tij faktin se subjekti i rivlerësimit duhet konsideruar i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit, për shkak se konsiderohet person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale. Kolegji e gjen këtë kërkim të subjektit të rivlerësimit, përveçse të pabazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, që përcakton provën e re, por njëkohësisht edhe krejt të panevojshëm e alogjik, duke qenë se Komisioni nuk ka kryer vlerësimin e kriterit të figurës për subjektin dhe e ka përfunduar procesin e rivlerësimit për këtë subjekt, mbështetur në dy kritere, atë të kontrollit të pasurisë dhe kontrollin e kriterit të aftësive profesionale. Gjithashtu, edhe nëse ky dokument do t’i nënshtrohej vlerësimit të Kolegjit, ai për shkak të përmbajtjes së tij, logjikisht nuk do të sillte asnjë përfitim në drejtim të pretendimeve e interesave të subjektit se vendimi i Komisionit që ka shkarkuar atë nga detyra, është i padrejtë.

7.6 Përveç këtyre konstatimeve, Kolegji shqyrtoi gjithashtu edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të gjykuar këtë çështje në seancë gjyqësore publike, por në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të arritura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, nuk u evidentua ndonjë shkelje procedurale apo konstatim i gabuar i situatës faktike në kuptim të nenit 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor për të siguruar korrektimin e tyre, siç subjekti pretendon.

7.7 Në këto rrethana, Kolegji çmoi se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, prandaj vendosi që gjykimi të zhvillohej në dhomë këshillimi, konform përcaktimeve të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, që referon te zbatimi i nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Shqyrtimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor

8. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se procesi i zhvilluar nga Komisioni është zhvilluar në kundërshtim me procesin e rregullt ligjor, pasi hetimi i kryer ka qenë i njëanshëm dhe i realizuar në kundërshti të plotë me normat procedurale e në zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe se nuk kanë gjetur respektim të plotë në procesin dhe në vendimmarrjen e Komisionit: (i) parimi i ligjshmërisë; (ii) parimi i drejtësisë dhe paanësisë; (iii) parimi i barazisë para ligjit; (iv) parimi i mbrojtjes juridike dhe të lirive dhe të drejtave Kushtetuese; (v) parimi i proporcionalitetit; (vi) parimi për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor,* Kolegji konstaton së pari se subjekti këto pretendime vetëm i citon, por pa i trajtuar e analizuar ato lidhur me situatën faktike apo me rrethanat e ndodhura apo verifikuara gjatë hetimit administrativ që konkretizojnë e provojnë pretendimet e tij për shkelje të këtyre parimeve.

8.1 Pavarësisht asaj që u përshkrua më lart, Kolegji vlerësoi dhe analizoi në funksion të zgjidhjes dhe dhënies përgjigje të këtyre pretendimeve, të gjithë veprimtarinë procedurale të zhvilluar nga Komisioni dhe konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në një komunikim të shpeshtë me Komisionin gjatë gjithë fazës së hetimit administrativ. Atij i janë drejtuar pyetje për çështje të ndryshme dhe subjekti ka kthyer përgjigje të cilat janë vlerësuar nga Komisioni para hartimit të raportit për rezultatet paraprake të hetimit, si edhe në vendimin e marrë për këtë çështje.

8.2 Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar me pyetje⁵ subjektit edhe për çështje për të cilat ai kishte dhënë përgjigje kontradiktore me deklaratimet e bëra në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në deklaratat periodike vjetore (në vijim “DPV”). Marrja pjesë në mënyrë aktive e subjektit të rivlerësimit përgjatë procedurës hetimore, por edhe të qenit aktiv dhe i përfaqësuar nga avokati, edhe në seancë dëgjimore publike, gjatë së cilës subjekti ka qenë i lirë të shpjegojë e parashtrijë prapësimet e tij, ngrejë pretendime e të mbrohet publikisht ndaj gjetjeve të Komisionit, duke paraqitur edhe në këtë seancë prova të reja që iu administruan nga trupi gjykues i Komisionit, tregon se subjekti ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtën e tij për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur.

Lidhur me zbatimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, referuar akteve të administruara në fashikull, rezulton se subjekti gjatë gjithë hetimit administrativ ka pasur mundësinë të paraqesë dokumente/prova në mbështetje të shpjegimeve të tij. Në respektim të këtij parimi dhe të së drejtës për t’u mbrojtur, trupi gjykues i Komisionit ka pranuar kërkesën e tij për shtyrjen e afatit për zhvillimin e seancës dëgjimore, me qëllim dhënien e mundësisë për paraqitjen e akt-ekspertimit financiar dhe atij të vlerësimit të pasurisë. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se Komisioni ka argumentuar ligjërisht refuzimin e kërkesës së subjektit për thirrjen e dëshmitarëve, pasi për çështjet për të cilat kërkoheshin të thirreshin dëshmitarët, ishin administruar dokumente shkresore dhe se faktet e kërkuara për t’u provuar me dëshmitarë ishin provuar gjatë hetimit administrativ, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

⁵ Referuar akteve të administruara nga Komisioni, rezulton se komunikimi i tij me subjektin është bërë nëpërmjet postës elektronike me mbi më shumë se 5 pyetësorë/komunikime për çështje të ndryshme.

Në këto kushte, Kolegji çmon se Komisioni ka respektuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit të gjitha garancitë që ofrohen nga zbatimi i parimeve të pretenduara si të shkelura prej tij e që konsistojnë në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e nenit 6 të KEDNj-së.

8.3 Lidhur me pretendimin e subjektit se zhvillimi i procesit hetimor vetëm për dy kritere, përkatësisht për kontrollin e pasurisë dhe vlerësimin e aftësive profesionale, ka sjellë shkeljen e parimeve ligjore të shprehura qartë në Kushtetutë dhe në ligjin e posaçëm, Kolegji çmon se është një pretendim i padrejtë dhe i pabazuar, pasi vjen në kundërshtim si me përcaktimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe me qëndrimin tashmë të konsoliduar të mbajtur në jurisprudencën⁶ e Kolegjit për këtë çështje.

Kjo dispozitë ligjore përcakton qartazi se rivlerësimi është një proces i cili jo domosdoshmërisht fillon dhe finalizohet me shqyrtimin e 3 kritereve të procesit të rivlerësimit. Ky interpretim shihet në lidhje të ngushtë e në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 1 parashikon se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit *në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale*. Ky parashikim i nenit 59, i cili me qëllim konfirmimin në detyrë të një subjekti kërkon domosdoshmërisht vlerësimin pozitiv të 3 (tri) kritereve së bashku, duke u interpretuar *a contrario* lejon përfundimin e procesit të rivlerësimit edhe mbështetur vetëm në një ose dy kritere, në rastet kur për Komisionin rezulton se nga hetimet e kryera për këto kritere, subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm, aq sa konfirmimi në detyrë nuk është më një opsion i vlefshëm.

8.4 Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit të cilat ai ka paraqitur kundërshtitë e tij në lidhje me aspektin procedural të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se:

i. Komisioni kishte detyrim ligjor të kryente një hetim të pavarur dhe të merrte vetë prova, me qëllim arritjen e një konkluzioni për dhënien ose jo të masës disiplinore, dhe se nuk mund të ketë një rol pasiv.

ii. Në aspektin procedural, subjekti pretendon se Komisioni duhej që për çdo çështje që i ka kaluar barrën e provës, të shprehej me vendim të ndërmjetëm lidhur me pranimin ose jo të provave të paraqitura; e se Komisioni, pas kalimit të barrës së provës, nuk i bëri me dije se cilat nga provat e shpjegimet e dhëna nga subjekti u pranuan dhe cilat jo dhe arsyet përkatëse të mospranimit të tyre, kjo në kuptim të detyrimit për respektim të parimit për t'u dëgjuar e mbrojtur në raport me gjetjet e Komisionit që prezumojnë shkarkimin nga detyra në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

iii. Komisioni kreu seancën dëgjimore publike pa kryer vlerësimin e shpjegimeve dhe të provave të paraqitura për to nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, si dhe nuk i ka bërë me dije subjektit rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës.

iv. Komisioni, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës sipas ligjit për vlerësimin e KLD-së, për disa nga gjetjet e këtij institucioni, duke parashtruar se për pasojë nuk e gjen të drejtë dhe të argumentuar pse

⁶ Vendimi nr. 1/2019 (JR), datë 31.01.2019; vendimi nr. 3/2013 (JR), datë 07.02.2019; vendimi nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; vendimi nr. 12/2018 (JR), datë 29.05.2019; vendimi nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; vendimi nr. 28/2019 (JR), datë 24.10.2019.

konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale është i ndryshëm nga ai i KLD-së i bërë për të.

8.5 Në drejtim të analizimit dhe të verifikimit të pretendimit lidhur me hetimin e pavarur të Komisionit, Kolegji vëren se vendimi i Komisionit nr. 100, datë 14.01.2019, në pjesën hyrëse të tij ka të shprehur se prej Komisionit është bërë hetim dhe vlerësim i të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke i listuar⁷ burimet e marrjes së të dhënave që i janë nënshtruar vlerësimit. Gjithashtu, referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, konstatohet se prej komisionerit relator është deklaruar se është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësim i pavarur i përfundimeve të paraqitura nga organet e tjera ndihmëse të procesit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë. Hetimi⁸ i pavarur i kryer nga Komisioni dëshmohet nga aktet e shumta të administruara në fashikull në funksion të verifikimit të deklarimeve të subjektit për kontrollin e pasurisë dhe të aftësive profesionale, akte me të cilat rezulton se vetë subjekti është njohur paraprakisht para seancës dëgjimore publike të zhvilluar nga Komisioni, duke ndjekur në këtë mënyrë interpretimin pajtues të mbajtur prej vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese⁹, në lidhje me rolin e raporteve të organeve ndihmëse në procesin e rivlerësimit, siç janë ILDKPKI-ja dhe inspektorati i KLD-së.

8.6 Kolegji këtë pretendim të subjektit e vlerëson të pambështetur, pasi të dhënat/provat, e gjetura nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni mbi verifikimin e kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, demonstrojnë qartazi se konkluzionet e Komisionit janë produkt i një hetimi të thelluar të kryer prej tij, fakt i cili në kundërshtim me sa pretendon subjekti, tregon për një rol aktiv të Komisionit përgjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje.

8.7 Kolegji gjithashtu gjen të pambështetur në rrethanat e çështjes pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka konsideruar dhe as ka marrë në shqyrtim provat e dorëzuara prej tij pas komunikimit të rezultateve paraprake të hetimit dhe kalimit të barrës së provës. Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni në analizën që u ka bërë gjetjeve që lidhen me kriterin e pasurisë apo atë të aftësive profesionale, i është referuar edhe qëndrimit apo shpjegimit të dhënë për gjetjet prej subjektit të rivlerësimit, si edhe akteve të dorëzuara prej tij në Komision¹⁰. Fakti që Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë me atë të pretenduar nga subjekti në lidhje me vlerën provuese të akteve të administruara gjatë hetimit, nuk mund të kuptohet si mohim i së drejtës për t'u dëgjuar e për të sjellë prova, por si ushtrim prej Komisionit i atributëve të tij analizuese e vlerësuese mbi çështje që shtrohen për diskutim

⁷ Në vendimin e Komisioni nr. 100, datë 14.01.2019, vërehet se në pjesën hyrëse të tij është shprehur qartazi se: “Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “vetting”;

b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;

c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;

d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;

e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit”.

⁸ Pjesë e këtij hetimi përmendim se janë korrespondencat e Komisionit me ZRVPP, ALUIZNI, DPSHTRR, OSHEE, Ujësjellës Kanalizime, Institucionet Bankare etj., të cilat janë listuar në vendimin nr. 100, datë 14.01.2019, të Komisionit.

⁹ Ky vendim në paragrafët 5.5, 5.6 dhe 5.7 shpjegon rolin e organeve ndihmëse, si: ILDKPKI-ja, lidhur me kriterin e pasurisë; DSJK-ja për kriterin e kontrollit të figurës; dhe KLD-ja e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.

¹⁰ Të tilla si aktet e ekspertimit, kontratat e depozituara pas kalimit të barrës së provës.

përgjatë procedurës administrative të rivlerësimit, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.*

8.8 Kolegji çmon gjithashtu se fakti që Komisioni ka marrë qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella prej subjektit të rivlerësimit dhe me ndikimin apo efektin që ato kanë mbi çështjet e ngritura, vetëm në vendim përfundimtar dhe jo në një moment paraprak para fillimit të seancës dëgjimore, nuk cenon në thelb të drejtën e subjektit për t'u mbrojtur. Sipas vlerësimit të Kolegjit, fakti që subjekti i rivlerësimit, është njoftuar nëpërmjet komunikimit të rezultateve paraprake të hetimit për çdo çështje apo gjetje të rezultuar nga hetimi, për të cilat ai duhet të jepte shpjegime apo sillte prova, duke i kaluar formalisht barra e provës, në zbatim e kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2006, provon se Komisioni e ka realizuar detyrimin e tij si organ administrativ, në kuptim e zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai duhej të rinjoftohej për qëndrimet e ndërmjetme të Komisionit në lidhje me provat apo prapësimet e paraqitura prej tij, para marrjes së vendimit përfundimtar, në mbështetje të po të njëjtit ligj, vlerësohet se artikulon një detyrim joproporcional e të paarsyeshëm për organin publik. Seanca dëgjimore e zhvilluar në këto kushte, i lë mundësinë subjektit të japë serish shpjegime e të paraqesë prova për gjithçka që vlerëson se është e nevojshme të dëgjohet referuar pikërisht atyre gjetjeve për të cilat Komisioni formalisht i ka kaluar barrën e provës e për të cilat subjekti duhet të përgjigjet, pasi mungesa e shpjegimit apo paraqitjes së provave do të sillte vendosjen e masës disiplinore. Nga verifikimi i veprimtarisë procedurale të zhvilluar në seancën dëgjimore, rezulton se subjekti ka pasur përgjatë saj të gjithë hapësirën për t'u dëgjuar e mbrojtur për çdo çështje të ngritur në rezultatet e hetimit, qoftë ato që lidhen me kriterin e pasurisë, qoftë ato që lidhen me kriterin e kontrollit të aftësive profesionale. Në konkluzion të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar e mbrojtur mbetet një pretendim abuziv, i pambështetur në asnjë të dhënë faktike apo parashikim ligjor.

8.9 Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me defektet strukturore të vendimit përfundimtar të dhënë nga Komisioni për çështjen e tij, duke e analizuar këtë pretendim në drejtim të aspektit faktik dhe parashikimeve ligjore. Në drejtim të shqyrtimit të këtij pretendimi, Kolegji vëren se vendimi nr. 100, datë 14.01.2020, i Komisionit, ka në përmbajtje të tij të gjitha elementet e detyrueshme, sipas përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, elemente të cilat e bëjnë këtë vendim të kuptueshëm në drejtim të konstatimeve që kanë dalë nga hetimi administrativ i zhvilluar për procesin e rivlerësimit të subjektit Alfred Gjoni, si dhe e bëjnë atë të qartë për të gjitha shkeljet e konstatuara dhe qëndrimet e mbajtura prej Komisionit në gjetjet e tij, e të përshkruara në pjesën arsyetuese të vendimit.

8.10 Po ashtu, mbetet i qartë edhe vullneti i Komisionit në drejtim të masës disiplinore të vendosur në pjesën urdhëruese të vendimit. Konstatimi i Kolegjit, në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, parashtruar në paragrafin 6.4 të këtij vendimi, për mospërdorimin e dispozitave ligjore respektive për cilësimin ligjor të situatave të ndryshme faktike, nuk e bën vendimin e Komisionit të cenueshëm, por e bën atë të korrigjueshëm e të ndreqshëm nëpërmjet juridiksionit korrektues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në zbatim të nenit F, pika 3 e Aneksit Kushtetues. Këtë proces korrektues, Kolegji do ta detajojë përgjatë gjithë arsytimit të këtij vendimi, me qëndrimet që do të mbajë më poshtë për çështjet e ngritura në nivelin e shkaqeve të shkarkimit, duke bërë cilësimin e duhur ligjor të tyre dhe duke orientuar Komisionin që të ndjekë këtë mënyrë në të ardhmen, në drejtim të nevojës për kualifikimet e duhura ligjore të situatave faktike e veçanërisht të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve.

8.11 Kolegji e gjen me vend të nënvizojë autoritetin orientues në këtë mënyrë, në përputhje me të drejtën që i jep neni 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe të potencojë nevojën për t'iu referuar këtij orientimi pikërisht në këndvështrim të rëndësisë së këtij momenti procedural që duhet të garantojë të drejtën e palëve për t'u mbrojtur e për të ushtruar një ankim efektiv në zbatim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 13 të KEDNj-së.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë

9. Në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, rezulton se Komisioni ka kryer një hetim administrativ të plotë lidhur me verifikimin e deklarimeve e ligjshmërisë së burimeve të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur shkelje të konstatuara si në drejtim të deklarimeve të bëra në lidhje me këtë kriter, por edhe në drejtim të provueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të tij. Komisioni ka mbajtur qëndrimet e tij në këtë drejtim, të adresuara për çdo pasuri të deklaruar e të hetuar prej tij.

9.1 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim pretendimet e tij në raport me konkluzionet e Komisionit, duke kontestuar në vija të përgjithshme analizën financiare të kryer dhe moskonsiderimin me cilësinë e provës së aktit të ekspertimit kontabël dhe atij vlerësues të pasurisë, të paraqitura prej subjektit, rrethana që sipas tij e kanë çuar Komisionin në konkluzione të gabuara në drejtim të mungesës së burimeve të ligjshme në krijimin e pasurive. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka kontestuar në mënyrë konsekuente të gjitha qëndrimet e Komisionit në lidhje me deklaratimet e shpjegimet e dhëna prej tij përgjatë procesit të rivlerësimit, duke pretenduar se ai ka qenë i vërtetë dhe korrekt në të gjitha deklaratimet e qëndrimet që ka mbajtur. Nga analiza e vendimit të Komisionit dhe veçanërisht e konkluzioneve të mbajtura prej tij për çdo aset në pronësi të subjektit të rivlerësimit, por edhe për qëndrimet e mbajtura prej subjektit, përgjatë procedurës administrative të kryer nga Komisioni, konstatohet se është konkluduar se në mënyrë të vazhdueshme e konsekuente, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrime kontradiktore e ka bërë deklarime të rreme, të cilave u janë bashkëlidhur konkluzione respektive të Komisionit për situatat konkrete në të cilat është vërejtur kjo dukuri.

Kolegji e sheh të nevojshme të veçojë përgjatë këtij arsyetimi që do të lidhet me shqyrtimin e shkaqeve të ankimit për kriterin e kontrollit të pasurisë, ato konkluzione të Komisionit, për t'i arsyetuar e shqyrtuar në kuadër të procedurës së rivlerësimit për të cilën Kolegji ka një këndvështrim që në vlerësimin e tij meriton një trajtim specifik e një kualifikim të ndryshëm ligjor nga ai që ka bërë Komisioni.

9.2 Lidhur me sa ka pretenduar subjekti për rezultatet e analizës së kryer nga Komisioni, referuar akteve të administruara në fashikull, rezulton se subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës pas kalimit të barrës së provës dokumentacion shoqërues¹¹.

¹¹ - Akti i ekspertimit kontabël, i përgatitur nga ekspertja kontabël e miratuar, znj. V.K.

- Deklarata e të ardhurave nga biznesi të realizuara në vitin 1995, në vlerën 317.300 lekë, e deklaruar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatim Taksave Kurbin (dorëzuar në Komision datë 04.01.2019).

- Certifikatë e regjistrimit në organin tatimor, nr. serial {***} dhe kod fiskal {***}.

- Njoftim vlerësimi i vitit 1996 nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Kurbin, me vlerë 513.000 lekë (dorëzuar në Komision datë 04.01.2019).

- Vërtetim nga ISSh, me nr. {***} dhe {***}, për babain dhe nënën e subjektit të rivlerësimit.

- Deklaratë noteriale e babait, z. N.Gj., mbi borxhin prej 500000 lekësh, të dhënë në vitin 2001.

- Raport vlerësimi i kryer nga Studio Vlerësuese "{***}" ShPK, përfaqësuar nga ing. vlerësuese I.S.

9.3 Nga shqyrtimi i akteve, rezulton se Komisioni ka marrë në shqyrtim pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* dhe konkretisht:

○ Apartament banimi, me sip. 60 m², me nr. pasurie {***}, në zonën kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}, me adresë rr. “{***}”, Tiranë, blerë me kontratën e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2001, me çmim 1.900.000 lekë.

Burimi i krijimit: Kursimet nga paga ndër vite, si dhe kontributi që i kanë dhënë familjarët e tij, babai dhe vëllai. Këta të fundit i kanë siguruar shumat e parave nga shitja e pronave në qytetin e Laçit, dyqan i shitur në periudhën 1997-1998, tokë e përfutuar nga ligji nr. 7501 “Për tokën”, me sip. 10.000 m², e shitur në vitin 2000 dhe banesë e shitur nga privatizimi në qytetin e Laçit.

9.4 Në vendimin e Komisionit, pas kryerjes së analizës financiare dhe shqyrtimit të provave dhe shpjegimeve të sjella nga subjekti i rivlerësimit, për apartamentin me sip. 60 m², me nr. pasurie {***}, është konkluduar se:

i. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1.154.846 lekë për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “vetting”, në lidhje me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.

iii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti.

iv. Subjekti i rivlerësimit i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet për mobilimin e këtij apartamenti.

9.5 Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit për sa u përket konkluzioneve të Komisionit në lidhje me këtë pasuri duke i analizuar ato në mënyrë integrale në raport me rrethanat e faktit që kanë rezultuar nga hetimi. Komisioni ka verifikuar në lidhje me këtë pasuri burimet e deklaruara se janë përdorur për krijimin e tyre. Nga deklarata *vetting*, rezulton se një prej burimeve janë të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në vite, të cilat i janë nënshtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar pretendime në ankim, por ka bërë një kontestim të përgjithshëm, duke pretenduar përdorimin e rezultateve të aktit të ekspertimit kontabël të hartuar nga ekspertja V.K. si referimin e saktë të të dhënave financiare që, sipas tij, duhet të llogariten në analizën financiare, duke parashtruar se Komisioni nuk ka njohur dhe nuk ka llogaritur si burim për krijimin e kësaj pasurie të ardhurat e krijuara nga familjarët e subjektit të rivlerësimit nga shitja e pronave të disponuara prej tyre e të pretenduara si burim krijimi.

9.6 Kolegji pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit në lidhje me këto qëndrime të Komisionit, arriti në përfundimin se ato nuk gjejnë mbështetje në faktet e rezultuara gjatë hetimit, duke arsyetuar si më poshtë.

Shuma e deklaruar prej subjektit si dhurim nga familjarët, në vlerën prej 500.000 lekësh, me burim shitjen e një dyqani në qytetin e Laçit, në periudhën 1997-1998, nuk provohet se ka shërbyer si burim për financimin e kësaj pasurie. Në lidhje me këtë shumë, konstatohet se vetë subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar disa herë qëndrimin për sa i takon marrëdhënies së tij me këtë sasi parash. Konkretisht, rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është dhuruar prej familjarëve, ndërsa pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, për të provuar këtë marrëdhënie dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume, subjekti ka ndryshuar qëndrim duke deklaruar se kjo shumë nuk i është dhuruar, por vetëm i është dhënë hua

prej babait për periudhën nga janari i vitit 2001 deri në janar 2035. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision edhe deklaratën e huas nr. {***}, datë 11.12.2008, të lidhur mes tij dhe babait N.Gj. para noterit publik.

9.7 Ky ndryshim i qëndrimit të subjektit të rivlerësimit në këtë fazë të procesit duket se lidhet me pamundësinë për t'i dhënë përgjigje pyetjes së shtruar nga Komisioni në lidhje me burimet financiare të familjarëve të tij për të blerë apartamentin e ndodhur në Tiranë, me vlerë prej 1500000 lekësh, në vitin 2001. Duke qenë se subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash të familjarëve të tij për blerjen e këtij apartamenti të njëjtat burime që ka deklaruar se kanë shërbyer për t'i dhënë atij dhuratë këtë shumë dhe është gjendur në pamundësi për të shpjeguar matematikisht pasjen e kësaj shume prej familjarëve, ka ndryshuar deklarinimin për sa i përket marrëdhënies juridike të tij me këtë shumë, duke deklaruar se ajo nuk është dhuratë, por një hua, e cila do të shlyhet pas 34 vitesh.

9.8 Sipas vlerësimit të Kolegjit, Komisioni me të drejtë ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të rreme në deklaratën *vetting* për sa i përket këtij burimi të ardhurash për të krijuar këtë pasuri, për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka pohuar me shpjegimet e deklarinimit e tij të mëparshme se ky deklarim është i pavërtetë, duke plotësuar në këtë mënyrë kriteret për kualifikimin si deklarim i rremë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/201612.

9.9 Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni nuk e ka njohur këtë shumë si një burim të ardhurash të ligjshme për t'u konsideruar si e tillë në analizën financiare për këtë pasuri, pasi e paprovuar dhe e pabesueshme konsiderohet të jetë edhe marrëdhënia e huas në këtë shumë, sipas deklarimeve të mëpasshme të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, kontrata e huas e deklaruar se është lidhur mes subjektit dhe babait të tij, e cila përcakton kthimin e shumës në vitin 2035 (konsideruar moshën e babait të subjektit të datëlindjes 1936) duket aspak realiste për natyrën e një marrëdhënie huaje, analizuar edhe me pamundësinë financiare të familjarëve të tij për ta pasur në dispozicion këtë shumë, për sa rezulton nga një analizë e thjeshtë logjike e matematike e të ardhurave të tyre të deklaruara prej subjektit e të përdorura, po sipas deklarimeve të tij, për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë, e çojnë Kolegjin në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur të provojë as marrëdhënien e huas së deklaruar prej tij dhe as burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur (babai i subjektit) për të krijuar këtë pasuri. Në këtë kuptim, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kjo shumë e pretenduar prej subjektit se ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament i ndodhur në Tiranë, nuk do të konsiderohet si e tillë në analizën financiare që Kolegji ka kryer për të verifikuar mundësitë financiare të subjektit për të krijuar këtë pasuri.

9.10 Pretendimet e tjera të subjektit se kjo shumë është krijuar nga të ardhurat e nxjerra prej aktivitetit tregtar të një bar-bufeye në qytetin e Laçit në vitet 1994-1996, janë paraqitur vetëm pas kalimit të barrës së provës dhe nuk i janë nënshtruar asnjë vlerësimi prej Komisionit, për shkak të faktit se vetë subjekti nuk i ka pretenduar ato si burime në deklarinimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, në përputhje me detyrimin ligjor. Në këto rrethana, me të drejtë Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare të kryer për të verifikuar mundësitë e subjektit për financimin e pasurisë së blerë prej tij.

¹² Neni 38 i ligjit nr. 9049/2003 parashikon se deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato, janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjisllacionit në fuqi.

9.11 Mbetet gjithashtu i paprovuar pretendimi i subjektit se familja e tij ka krijuar të ardhura nga toka, sipas vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit {***}, i datës 29.12.2018, në të cilin deklarohet që familja e tij, e përbërë nga 5 anëtarë, është pajisur me tokë arë, me sip. 10517 m², në fshatin {***}, si përfituese e ligjit nr. 7501 “Për tokën” dhe se ata e kanë punuar e përdorur atë për të mbuluar nevojat e tyre familjare nga viti 1992 deri në vitin 2002. Të dhënat e prezantuara në këtë akt, nuk provojnë dhe as kuantifikojnë të ardhurat nga përdorimi i kësaj pasurie, në funksion të detyrimit që ka subjekti i rivlerësimit në këtë proces, për të provuar me dokumentacion burimet e krijimit të pasurisë së tij.

9.12 Në lidhje me përdorimin si burim për krijimin e kësaj shume të të ardhurave të pretenduara nga shitja e dy pasurive të tjera të familjarëve të tij, tokë arë prej 10517 m², e ndodhur në Fushë-Mamurras, dhe shtëpi banimi në qytetin e Laçit, Kolegji vëren se me të drejtë Komisioni ka konstatuar se këto janë dy pasuri të shitura prej familjarëve të subjektit përkatësisht më datë 22.06.2001 dhe më datë 02.02.2002, pra pas blerjes prej subjektit të apartamentit prej 60 m² të ndodhur në Tiranë, në datën 06.06.2001 dhe, për pasojë, nuk mundet që të ardhurat e krijuara prej tyre në një periudhë më të vonë, të kenë shërbyer si burim krijimi për të financuar një pasuri të blerë më parë. Përpos këtij arsytimi, edhe në drejtim të verifikimit të këtyre burimeve, nga analiza logjike e fakteve të deklaruara prej vetë subjektit të rivlerësimit, këto të ardhura janë përdorur prej familjarëve të tij për të blerë ata vetë në vitin 2001 apartamentin e ndodhur në Tiranë, në vlerën prej 1.500.000 lekësh. Në konkluzion, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se të ardhurat e familjarëve të subjektit nuk mund të jenë përdorur si burim për krijimin e pasurisë apartament të subjektit të rivlerësimit, pasi, në zbatim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk është provuar ekzistenca e kësaj marrëdhënieje dhe as burimi i ligjshëm i krijimit të një shumë të tillë nga familjarët e tij, e mjaftueshme për t’ia dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Në këtë përfundim të Kolegjit, ndërthuren elemente të analizës së deklarimeve të subjektit, si edhe një vlerësim logjik e i arsyeshëm i të gjitha rrethanave që lidhen me burimet financiare të familjarëve të tij, si persona të tjerë të lidhur, për të mundësuar realisht dhënien e kësaj shume si hua.

9.13 Kolegji në këtë kuadër vlerësoi si të drejtë edhe qëndrimin e mbajtur prej Komisionit në drejtim të mosvlerësimit me cilësinë e provës së aktit të ekspertimit kontabël, të paraqitur prej subjektit gjatë procedurës administrative, duke qenë se më shumë sesa një herë në atë akt, konstatohet pasqyrim jo i vërtetë i fakteve e rrethanave krahasuar me të dhënat që burojnë nga dokumentet zyrtare, si burime të njohura në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si edhe konstatohen gabime të rëndësishme logjike e matematike, të cilat, të gjitha së bashku, e deformojnë rezultatin e arritur në përfundim të tij¹³.

9.14 Për sa më lart, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë e trajtuar më lart, duke përdorur konkluzionet e përshkruara në drejtim të burimeve të ligjshme të përdorura për krijimin e saj, ka rezultuar se subjekti gjendet në kushtet e një balance negative financiare në drejtim të

¹³ Në analizën financiare të kryer nga eksperti kontabël i përzgjedhur nga subjekti për periudhën 1995-2001 ka këto pasaktësi:

- është përfshirë dy herë paga e vitit 2001 (në vlerë 431.951 lekë);
- është përfshirë vlera prej 500.000 lekësh, që rrjedh nga kontrata e shitjes së apartamentit në qytetin e Laçit me nr. {***}, më datë 22.06.2001;
- mungon evidentimi i shpenzimeve të jetesës.

mbulimit me të ardhura të ligjshme për përballimin e shpenzimeve për jetesë dhe krijimin e kësaj pasurie deri në vitin 2001, për një vlerë prej (-) 731.637 lekësh¹⁴.

9.15 Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit në drejtim të konkluzionit të Komisionit se çmimi i përcaktuar në kontratën për blerjen e këtij apartamenti prej 1.900.000 lekësh, duket i dyshimtë dhe i pajustificuar në raport me çmimin e përcaktuar për metër katror në atë vit nga Udhëzimi nr. 5, datë 31.05.2001, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave" nga Enti Kombëtar i Banesave.

9.16 Kolegji vlerëson se ky qëndrim i Komisionit, sipas të cilit transaksioni për blerjen e këtij apartamenti konsiderohet një veprim financiar i pajustificuar dhe i pambështetur në ekonominë e tregut, për sa kohë që është blerë me një çmim më të ulët se ai që përcaktojnë aktet rregullatore të kohës për shitjen e pasurive nga Enti Kombëtar i Banesave, përveç se mbetet një konkluzion i pasaktë për sa kohë që referon në mënyrë të panevojshme zbatimin e një legjislacioni mbi çmimet e banesave shtetërore në një fushë të qarkullimit civil që del jashtë fushës së mbulimit të këtij akti, por duket edhe një konkluzion i panevojshëm për t'u adresuar në këtë proces, për sa kohë që ai nuk lidhet me ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi apo marrëdhënieje të dyshuar si të lidhur me detyrën për subjektin e rivlerësimit. Analiza e Komisionit në rastin konkret, për sa kohë që kontrata e lidhur mes palëve përcakton një çmim për blerjen e apartamentit, në dukje më i ulët se ai që përcaktojnë aktet shtetërore që rregullojnë shitblerjen e banesave në një treg dhe kontekst krejt të ndryshëm, do të ishte e arsyeshme të kryhej në rast se do të lidhej me një aktivitet të dyshuar si të kundërligjshëm të subjektit të rivlerësimit dhe do t'i jepte kuptim këtij konkluzioni.

Në kushtet e ndodhura në këtë proces, ky konkluzion për Kolegjin nuk mund të shërbejë si një shkak që mund të renditet ndër ato që kanë shkaktuar shkarkimin e subjektit nga detyra, edhe sepse për si është analizuar nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit nuk mund të zbatojë në rrethanat konkrete të hetimit të kryer në Komision një kualifikim ligjor nga ato që parashikon neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 në drejtim të referimit si deklaram i pamjaftueshëm, për pasojë, nuk konsiderohet prej Kolegjit si një shkak për të justifikuar masën disiplinore të vendosur ndaj subjektit.

9.17 Në përfundim të analizës së kryer si më lart, në funksion të dhënies përgjigje të pretendimeve të parashtruara në ankim në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 60 m² në rrugën "{***}" në Tiranë, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme financiare, në masën prej (-) 731.637 lekësh, krijimin e kësaj pasurie, si edhe rezulton se ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *vetting*, për sa i përket natyrës së marrëdhënies juridike nëpërmjet të cilës ai ka përfituar si burim për krijimin e pasurisë, shumën prej 500.000 lekësh, të cituar si një prej burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur para kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, gjerat "b" dhe "ç" të ligjit nr. 84/2016.

- 10.** Në analizë të pretendimeve të subjektit për pasurinë apartament banimi, me sip. 47,74 m², me nr. pasurie {***}, Zona Kadastrale {***}, volumi {***}, faqe {***}, ndodhur në rr. "{***}", legalizuar me lejen e ndërtimit nr. {***}, datë 23.04.2013, me numër serial {***}, me vlerë të shpenzuar jo më shumë se 600.000 lekë, rezulton se subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar se burimi i krijimit janë të ardhurat e kursyera nga paga ndër vite dhe se ndërtimi i kësaj shtese ka filluar në vitin 2011, duke investuar çdo vit nga pak.

¹⁴ Nga analiza financiare rezultojnë një diferencë negative në vlerën (-) 731.637 lekë, në versionin kur shpenzimet e jetesës janë konsideruar në masën 30% për të ardhurat e viteve 1995-1999, si dhe në vlerën (-) 1.064.559 lekë në versionin kur shpenzimet e jetesës janë konsideruar në masën 66% për të ardhurat e viteve 1995-1999.

10.1 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar në vendim se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën *vetting* në lidhje me vitin e ndërtimit të apartamentit¹⁵, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për ndërtimin e kësaj shtese, dhe se ka dhënë përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe nuk a ka deklaruar atë në deklaratat periodike të interesave privatë të viteve 2003-2008.

10.2 Subjekti në ankim, për apartamentin 47,74 m², ka parashtruar se vlera e këtij apartamenti (shtese) nuk është ajo e përcaktuar prej Komisionit, por ajo që ka përcaktuar ekspertja I.S. në aktin e ekspertimit për vlerësimin e pasurisë dhe ajo që ka deklaruar vetë subjekti, dhe se të ardhurat e tij mbulojnë me burim të ligjshëm ndërtimin e kësaj shtese.

10.3 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni dhe nga aktet e administruara gjatë hetimit, si: deklaratat periodike të pasurisë¹⁶ (DVP), praktika e ALUIZNI-t dhe shpjegimet e dhëna gjatë përgjigjeve që i janë drejtuar subjektit për apartamentin 47,74 m², ka rezultuar se subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DVP-në e vitit 2008, duke e përshkruar si një verandë me sip. 47,7 m², për legalizim. Ai e ka deklaruar sërish atë në vitin 2012, duke e përshkruar si shtesë apartamenti në pritje të legalizimit. Më pas, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DVP-në e vitit 2014 si të përfunduar në atë vit, me vlerë 50000 lekë. Ndërsa në deklaratën *vetting*, lidhur me këtë pasuri, ka deklaruar se ky apartament banimi me sipërfaqe prej 47,74 m², është legalizuar me lejen nr. {***}, datë 23.04.2013, dhe se për ndërtimin tij ka shpenzuar jo më shumë se 600000 lekë. Ai ka përcaktuar në këtë deklaratë se ndërtimi i kësaj shtese ka filluar në vitin 2011 e duke investuar çdo vit nga pak.

10.4 Referuar akteve të administruara prej ALUIZNI-t¹⁷ gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se z. Alfred Gjoni ka vetëdeklaruar për legalizimin e ndërtimit informal me sip. 47,74 m², me adresë rr. “{***}”, Njësia. Nr. {***} Tiranë dhe është pajisur me leje legalizimi nr. {***} prot., datë 23.04.2013. Vetëdeklarimi është regjistruar me nr. {***}, datë 21.09.2006, si dhe me numër {***}, datë 04.10.2006. Nga kjo praktikë rezulton se në formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, në funksion të legalizimit, lexohet qartë data 21.09.2006 dhe vlera prej 1309938 lekësh.

Gjithashtu në fashikull gjenden të administruara akte të sjella në cilësinë e provës nga vetë subjekti, me shpjegimet e tij për rezultatet paraprake të hetimit, nga të cilat rezultojnë të dhëna për kohën e ndërtimit të kësaj shtese. Nga raporti i oponencës teknike i datës 05.09.2007, i lëshuar nga Instituti i Ndërtimit, prezumohet fakti që objekti kishte përfunduar në vitin 2007,

¹⁵ Të cilën në shpjegimet e tij subjekti, si dhe ekspertja vlerësuese e pasurisë, e referon si shtesë anësore të apartamentit prej 60 m², në Tiranë, e cila pas përfundimit të procesit të legalizimit, është regjistruar në ZRVPP si apartamenti me sip. 47 m².

¹⁶ Në DVP ndër vite dhe në deklaratën “*vetting*”, subjekti ka deklaruar:

- Subjekti shtesën e apartamenti e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën vjetore të pasurisë (DVP) të vitit 2008, tek e cila ka deklaruar: “shtesë verande me sip 47,7 m², për legalizim”, për të cilën nuk ka deklaruar vlerë.
- Në DVP-në e vitit 2012, subjekti deklaron: “në pritje të legalizimit të një shtese prej 48 m²(shtesë apartamenti), e mbartur”.
- Në DVP-në e vitit 2014, subjekti deklaron: “shtesë e bërë në apartament me sip. 47 m², ka përfunduar totalisht, në vitin 2014, vlera 50.000 lekë”.
- Në deklaratën “*vetting*”, subjekti e ka deklaruar këtë apartament banimi me sip 47,74 m², të legalizuar me lejen nr. {***}, datë 23.04.2013, për ndërtimin e të cilit ka shpenzuar shumën prej 600.000 lekësh, si dhe që ndërtimi ka filluar në vitin 2011, e duke investuar çdo vit nga pak.

¹⁷ Shkresa Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana {***}, nr. {***} prot., datë 20.02.2018.

duke qenë se ekspertët nuk mund të certifikonin punimet dhe të kryenin Oponencën Teknike për një objekt të përfunduar.

Të dhëna të ngjashme rezultojnë edhe nga deklarata noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., e datës 12.12.2018, e shtetasit S.M., i cili deklaroi se në maj të vitit 2007 ka bërë punime në një papafingo me dru, me sipërfaqe 45 m², me çmim total 600.000 lekë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përgjatë hetimit administrativ periudha të ndryshme kohore për ndërtimin e kësaj shtesë/apartamenti, duke e spostuar ndërtimin në vitet 2004 e 2006 dhe përfundimin e saj në vitin 2009, duke e ndarë atë në periudha edhe për efekt të shpërndarjes së vlerës së investimit për ndërtimin e saj në këto kohë¹⁸.

10.5 Në analizë të situatës faktike të referuar më sipër, lidhur me shtesën/apartament 47,74 m², nga aktet e administruara, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit e ka vetëdeklaruar pranë ALUIZNI-t këtë shtesë që në vitin 2006 dhe ky fakt provon se ky objekt ka qenë i përfunduar që në këtë vit, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit për herë të parë këtë objekt e deklaroi në DVP-në e vitit 2008, në të cilën nuk shprehet për vlerën e investimit dhe burimin e krijimit të tij.

Në DVP-në e vitit 2014 rezulton se subjekti ka bërë për herë të parë deklarimin e investimit për shtesën, në vlerën 50.000 lekë, ndërkohë që ishte lëshuar leja e legalizimit të shtesës me nr. 98962 prot., datë 23.04.2013, nga ALUIZNI, situatë nga e cila përjashtohet logjikisht mundësia e shpenzimit të shumës prej 50.000 lekësh si shpenzim për ndërtimin e saj në vitin 2014, përderisa ajo rezultonte e legalizuar të paktën që një vit më parë, në vitin 2013.

10.6. Duke analizuar faktet e renditura si më lart, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për këtë pasuri. Së pari, siç u përshkrua në renditjen e mësipërme të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi, deklaratat e subjektit të rivlerësimit për kohën e ndërtimit në lidhje me këtë pasuri janë krejtësisht kontradiktore e në mungesë koherence të theksuar. Për Kolegjin konstatohet se bëhet e vështirë pikërisht për shkak të kësaj moskoherence të përcaktuar e të mbajë një qëndrim përfundimtar për kohën e ndërtimit të kësaj pasurie dhe madje edhe të definojë qoftë edhe në këndvështrim të qasjes së vetë subjektit, cila duhet të jetë koha e pranuar prej atij vetë në të cilën është ndërtuar ky objekt. Së dyti, ajo që konstatohet lehtësisht për sa i përket verifikimit të vërtetësisë së deklaratave të subjektit, është se deklarimi i tij në deklaratën *vetting*, se kjo shtesë është ndërtuar në vitin 2011, është krejtësisht i pavërtetë në kuptim të parashikimeve ligjore që rregullojnë këtë proces. Fakti që ky deklarim është i rremë, provohet me faktet që kanë rezultuar nga disa burime të ndryshme përgjatë hetimit administrativ, si: i) deklaratat e subjektit gjatë hetimit administrativ nëpërmjet të cilave ai pohon se në vitin 2011 është kryer vetëm mobilimi i shtesës; ii) vetëdeklarimi i tij tek ALUIZNI për ndërtimin e këtij objekti në vitin 2006; iii) raporti i oponencës teknike që tregon se në vitin 2007 objekti duhet të kishte përfunduar; iv) deklarimi i shtetasit S.M. se në vitin 2007 kishte kryer punime druri në papafingon e këtij objekti, që tregon se objekti kishte përfunduar tashmë. Për të gjitha këto fakte, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti ka bërë deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting* në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie, duke u gjendur në këtë mënyrë në situatën e parashikuar prej nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁸ Shtesa është ndërtuar me konstruksion të lehtë e pa themel, duke filluar që nga viti 2001, ajo qëndron në verandën e apartamentit të blerë dhe është pjesë integrale e tij. Kostoja e ndërtimit të përgjithshëm ka qenë në vlerën 600.000 lekë dhe është paguar nga kursimet e mia të punës pas vitit 2001. Si konstruksion i jashtëm ka përfunduar në vitin 2006, kohë në të cilën edhe kam aplikuar pranë Agjencisë së Legalizimit. Pjesa e parë e kësaj shtese, me sipërfaqe 23 m², është përfunduar në vitin 2004, ndërsa pjesa tjetër, me sip. 24,74m², është përfunduar në vitin 2006. Pajisja me orendi dhe rregullimi i brendshëm është i mëvonshëm. Për sa i përket citimit tim në deklarim se e kam ndërtuar në 2011, ka qenë për shkak se në këtë vit unë kam bërë përfundimisht edhe arredimin e kësaj shtese dhe mbylljen e saj përfundimtare.

10.7 Në lidhje me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit për mbulimin me të ardhura të ligjshme të vlerës së deklaruar prej tij për koston e ndërtimit të kësaj pasurie, Kolegji konstaton se përtej diskutimit që Komisioni ka bërë në lidhje me koston e ndërtimit të saj duke iu referuar në arsyetim vlerës së nxjerrë në zbatim të Udhëzimi nr. 5, datë 31.05.2001, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave” nga Enti Kombëtar i Banesave, sipas të cilit vlera e koston ka qenë jo 600.000 lekë, sa ka deklaruar subjekti, por në vlerën 1.187.492,5 lekë¹⁹, vetë Komisioni në analizën financiare të kryer për të verifikuar mundësitë e tij për financimin me burime të ligjshme të këtij ndërtimi, ka përdorur si kosto të shpenzimit të kryer shumë e pretenduar prej vetë subjektit, në vlerën prej 600.000 lekë. Në të njëjtën mënyrë, Komisioni ka pranuar në analizën e tij si vit të ndërtimit të objektit dhe shpërndarjes së shpenzimeve për ndërtimin, atë të deklaruar prej subjektit përgjatë shpjegimeve në hetimin administrativ, konkretisht vitet 2004 dhe 2006. Të njëjtat të dhëna i ka përdorur edhe Kolegji në analizën financiare të kryer prej tij, pavarësisht kontradiktave të theksuara dhe vështirësisë së shpjeguar më sipër në drejtim të përcaktimit në mënyrë bindëse të këtyre elementeve, por duke pranuar këto të dhëna në funksion të zbatimit të parimit të *no reformatio in peius*, duke qenë se vetë subjekti është dakordësuar me përdorimin e këtyre fakteve.

Nga analiza financiare e kryer duke përdorur këto të dhëna, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të përballuar krijimin e kësaj pasurie në vitet 2004 e 2006, në vlerat respektive (-) 4.994 lekë dhe (-) 720.313 lekë, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

11. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me konkluzionin e Komisionit se ai ka qenë në kushtet e pamundësisë financiare për të përballuar shlyerjen e kredisë, marrë nga Banka Raiffeisen në vitin 2007.

11.1 Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Kolegji duke analizuar faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, konstaton se subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie nga Banka Raiffeisen në vitin 2005, në shumë 400.000 lekë, në DPV-në e vitit 2005. Ai ka deklaruar shlyerje të kësteve të kësaj kredie vetëm në vitin 2005 dhe deklaroi si shumë të mbetur pa shlyer shumë prej 200.000 lekësh në DPV-në e vitit 2008. Ndërsa ka deklaruar se ka shlyer përfundimisht këtë kredi në DPV-në e vitit 2009.

11.2. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se Banka Raiffeisen, me shkresën nr. {***} prot., datë 7.02.2018, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë kredimarrës i kësaj banke, *për një kredi me vlerë 400.000 lekë, marrë më datë 18.07.2005 dhe mbyllur më datë 18.07.2007*. Referuar kësaj shkrese të cituar më lart, rezulton se kredia është shlyer plotësisht në vitin 2007, në kundërshtim nga sa ka deklaruar subjekti në deklaratat periodike, si për shlyerjen e kësteve ashtu edhe për momentin e likuidimit të plotë të saj.

11.3. Pavarësisht këtyre deklarimeve kontradiktore, Kolegji në analizën financiare që kreu në përgjigje të këtij pretendimi të subjektit, analizoi situatën e tij financiare në vitet 2005-2007, në funksion të verifikimit të mundësisë së tij për të shlyer me të ardhura të ligjshme vlerën e kredisë, duke iu referuar për sa i përket kohës dhe kësteve të shlyera, sipas të dhënave të përcjella nga Banka Raiffeisen, nëpërmjet shkresës së cituar më lart, dhe duke përfshirë në analizë të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara prej subjektit për këtë periudhë. Në përfundim të kësaj analize, rezultoi se subjekti gjendej në pamundësi financiare për të shlyer me të ardhura të

¹⁹ Në vendimin nr. 100, datë 14.01.2019, të Komisionit, faqe 15, jepet metodologjia e aplikuar nga Komisioni për llogaritjen e saj.

ligjshme këto pagesa dhe situata e tij financiare rezultonte me një balancë negative në vlerën 1.343.965 lekë, sipas analizës së kryer në Kolegj për vitet 2005-2007. Duke qenë se Komisioni ka konkluduar në vendimmarrjen e tij për një vlerë më të ulët të balancës negative, në shumën prej 1.033.637 lekësh, Kolegji konkludon në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, se kjo vlerë do të mbetet edhe ajo që do të konsiderohet prej Kolegjit në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë.

Në këto kushte, Kolegji e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit edhe për këtë moment, duke konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimit të ligjshëm për shlyerjen e kredisë në vitin 2007 dhe brenda parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

12. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar se ai gjendej në kushtet e mungesës së burimit të ligjshëm për të financuar shumën e dhënë hua E.Ç., në vlerën prej 495.000 lekësh, në vitin 2009.

12.1 Nga verifikimi i të dhënave në dosje, rezulton se kjo marrëdhënie mes subjektit dhe z. E.Ç. është bërë e ditur për Komisionin gjatë hetimit administrativ, për shkak të analizës së disa transaksioneve bankare të kryera nga llogaria rrjedhëse në emër të subjektit të rivlerësimit në ProCredit Bank, nëpërmjet të cilave është kryer transferimi i disa shumave monetare²⁰, gjithsej 495.000 lekë, prej llogarisë së subjektit tek ajo e shtetasit E.Ç. Këto lëvizje nuk janë deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në DVP-në e vitit 2009 dhe të vitit 2010, kur rezulton se janë bërë transaksionet, por janë shpjeguar prej tij vetëm gjatë hetimit administrativ, pasi Komisioni i ka bërë prezent subjektit këto lëvizje, duke i kërkuar gjithashtu një shpjegim për to. Në këtë fazë të procesit (përgjatë hetimit administrativ), subjekti ka shpjeguar se këto shuma përfaqësojnë një hua dhënë prej tij këtij shtetasi dhe se mosdeklarimi i tyre është një harresë e tij. Ndërsa ka shpjeguar se kjo hua i është kthyer nëpërmjet dorëzimit në *cash* me këste brenda një periudhe dyvjeçare. Këto shpjegime të subjektit të rivlerësimit janë mbështetur edhe nga deklaratimet e njëjta, të dhëna nga shtetasit E.Ç. e E.Ç.²¹.

12.2 Nga analizimi i rrethanave të faktit që lidhen me këtë situatë, Kolegji konstaton se konkluzioni i Komisionit për mungesë të deklaratimit të këtyre fakteve në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike përkatëse, 2009-2010-2011-2012, është i drejtë vetëm për sa i përket detyrimit ligjor të subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar në deklaratat periodike detyrimet apo të drejtat ndaj personave të tretë, në përputhje me parashikimin ligjor të nenit 4, gerrat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, datë 10.04.2003, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”).

²⁰Për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit i ka kaluar në llogari E.Ç. shumën prej 405.000 lekësh, ndërsa në vitin 2010 i ka kaluar edhe 91.500 lekë të tjera.

²¹Deklaratë noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 24.12.2018, nëpërmjet së cilës bashkëshortja e z. E.Ç., shtetasja E.Ç., deklaroi se më datë 27.07.2009, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë hua z. E.Ç. shumën 405.000 lekë, më datë 21.03.2010 i ka dhënë shumën prej 500.000 lekësh, ndërsa më datë 12.04.2010 i ka dhënë hua shumën prej 91.500 lekësh. Duke u shprehur se detyrimi përfundimtar është 696.500 lekë.

Me deklaratën noteriale nr. {***} rep. e nr. {***} kol., datë 24.12.2018, z. E.Ç. deklaroi se më datë 27.07.2009, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë hua shumën prej 405.000 lekësh, më datë 23.03.2010 i ka dhënë shumën prej 500.000 lekësh; ndërsa më datë 12.04.2010 i ka dhënë hua shumën prej 91.500 lekësh.

12.3 Kolegji, pavarësisht këtij fakti, nuk ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin se kjo shkelje e ligjit e kryer në raport me detyrimet e ligjit nr. 9049/2003, në vitet respektive si më lart cituar, të renditet si një shkak shkarkimi referuar kontrollit dhe verifikimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, Kolegji çmon të nënvizojë se shkeljet e konstatuara të ligjit të bëra në deklaratat periodike, do të jenë të analizueshme dhe të përdorshme në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, por ato nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkak shkarkimi si të vetme, sipas përgjegjësisë që subjekti ka në raport me deklarimet në deklaratën *vetting*, por mund të jenë rast pas rasti pjesë e vlerësimit tërësor që i bëhet kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo edhe në kuptim të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

12.4 Gjithashtu, Kolegji çmon se mungesa e deklarimit të kësaj marrëdhënieje në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk konsiderohet si shkelje e ndonjë detyrimi ligjor në kuptim të plotësimit të kësaj deklarate. Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjektet kanë detyrimin e deklarimeve të detyrimeve apo kredive që kanë ndaj personave të tretë në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, deklarime të cilat më pas i nënshtrohen verifikimit të vërtetësisë së tyre, ndërsa kredia e deklaruar prej subjektit i përket një kohe të shkuar dhe po ashtu edhe shlyerja e saj, pra marrëdhënia mes subjektit dhe shtetasit E.Ç., në lidhje me këtë hua, i ka përfunduar efektet e saj dhe nuk prodhon më asnjë pasojë ligjore që të mund të deklarohet si e tillë në vitin 2017, në kohën e plotësimit të deklaratës *vetting*.

12.5 Në këto kushte, Kolegji verifikoi nëpërmjet analizës financiare të kryer për vitet 2009-2010, mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të përballuar me të ardhura të ligjshme dhënien e kësaj huaje, dhe nga analiza rezultoi se ai në vitin 2009 gjendej në pamundësi financiare për ta mbuluar atë me të ardhura të ligjshme, në një vlerë jo më pak se 630.209 lekë, të konkluduar nga analiza financiare e kryer në Komision. Kolegji nuk konsideroi si një pretendim të bazuar të subjektit atë të paraqitur në aktin e ekspertit kontabël, punuar nga ekspertja kontabël V.K., sipas së cilës si të ardhura për përballimin e këtij shpenzimi kanë shërbyer gjendjet e lira potenciale që subjekti ka pasur në dispozicion vit pas viti, por që nuk janë deklaruar prej tij në deklaratat periodike. Në këtë kontekst, Kolegji nënvizon qëndrimin e mbajtur tashmë në mënyrë të konsoliduar prej tij²² se tepricat monetare, të cilat rezultojnë si të tilla nga një analizë hipotetike por që janë të padeklaruara apo të dokumentuara, nuk mund të konsiderohen se kanë ekzistuar vërtet, për sa kohë ekzistenca e tyre nuk gjen gjurmë provueshmërie në asnjë burim të njohur prove, por vetëm në analizat financiare të kryera nga subjektet pas prezantimit të gjetjeve të hetimit për mungesa të burimeve të ligjshme financiare. Në konkluzion, kjo situatë faktike e çon gjithashtu subjektin në parashikimet e nenit 33, pika, 5 germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 13.** Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit qëndrimi i mbajtur nga Komisioni për banesën në Durrës, të cilën e ka konsideruar si pasuri të fshehur të tij, nuk është i drejtë, pasi ai gjatë hetimit administrativ ka arritur të provojë se kushëriri i tij H.Gj., në

²² Vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019; nr. 20/2019 (JR), datë 26.07.2019.

favor të të cilit figuron e regjistruar kjo pasuri, ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti.

Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni në vendimin e tij nr. 100, datë 14.01.2019, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit [...] është në kushtet e fshehjes së posedimit dhe përdorimit të një apartamenti në qytetin e Durrësit [...] ka në pronësi të fshehur apartamentin në qytetin e Durrësit.

13.1 Subjekti në ankim ka pretenduar se konstatimet e Komisionit për fshehje të apartamentit në Durrës bien ndesh me të gjitha provat dhe aktet e dorëzuara prej tij gjatë hetimit administrativ. Ai ka pretenduar se për kushëririn e tij H.Gj. është provuar se ka pasur burime të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti, duke përdorur si prova për të mbështetur këtë pretendim akte të nënshkruara prej kryeplakut të fshatit që provojnë të ardhurat e tij dhe deklaratimet noteriale të shtetasve A.D. dhe M.R.

13.2. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se Komisioni ka marrë dijeni për marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri nëpërmjet një denoncimi anonim të dorëzuar në ILDKPKI, sipas të cilit subjekti e përdorte këtë pasuri si pronë të tij prej vitit 2009. Në vijim të hetimit të këtij fakti të denoncuar, Komisioni i ka drejtuar pyetje subjektit të rivlerësimit në drejtim të marrëdhënies së tij me këtë pasuri dhe subjekti është përgjigjur në mënyrë pohuese për të drejtën e përdorimit mbi këtë pasuri vetëm në pyetësorin e dytë drejtuar atij²³ dhe nuk e ka deklaruar këtë fakt as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në ato periodike, madje as në pyetësorin e parë standard që u drejtohet të gjitha subjekteve në nisje të procedurës hetimore.

13.3. Nga hetimi ka rezultuar se pasuria apartament, e ndodhur në lagjen nr. {***}, Rruga e {***}, ndërtesa {***}, hyrja {***}, kati i {***}, Durrës, është e regjistruar në ZRPP-në Durrës me nr. pasurie {***}, Volumi {***}, faqe {***}, në favor të shtetasit H.Gj., i cili, sipas deklaratimeve të subjektit, rezulton të jetë kushëri i tij. Pronësinë mbi këtë pasuri ky individ e ka fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep. e nr. {***} kol., datë 10.03.2014, nga shitësi B.O., përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga shtetasja K.T. dhe, sipas kontratës së huadhënies nr. {***} rep. e nr. {***} kol., datë 29.12.2018, deklaroi se ia ka dhënë në përdorim pa afat të caktuar kohor subjektit të rivlerësimit dhe se kjo marrëdhënie ka filluar që prej viti 2014.

13.4. Komisioni rezulton që ka hetuar në disa drejtime për të verifikuar faktet e paraqitura në denoncim, së pari në drejtim të verifikimit të mundësisë së shtetasit H.Gj. për të blerë me të ardhura nga burime të ligjshme apartamentin objekt hetimi, në zbatim të detyrimit të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, së dyti, në drejtim të verifikimit të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit mbi marrëdhënien që ai ka pretenduar se ka pasur me këtë pasuri.

13.5. Në lidhje me verifikimin e mundësisë së shtetasit H.Gj. për të blerë këtë apartament në vlerën prej 9.750.000 lekësh me burime të ligjshme, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se ai

²³ Pyetësori vijues pas atij standard, të përcjellë subjektit në momentin fillestar të nisjes së procesit të tij të rivlerësimit.

nuk rezulton të ketë pasur të ardhura të tilla që të justifikojnë blerjen e kësaj pasurie. Pretendimi i subjektit se ky shtetas ka krijuar të ardhura prej pasurive të tij bujqësore, vreshtave e blegtorisë dhe se këto të ardhura provohen me deklaratën e bërë prej tij në prezencë të kryeplakut të fshatit {***}, Dibër, mbetet vetëm në kuadër të një deklarimi, por i pambështetur në asnjë burim prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016, referuar burimeve të provave që mund të provojnë krijimin apo gjenerimin e të ardhurave, në kuptim të këtij procesi. Në njëtin nivel deklarativ janë edhe pretendimet për krijimin e të ardhurave të krijuara nga puna sezonale e shtetasit H.Gj. në Greqi, të ardhura për të cilat nuk është paraqitur asnjë dokument justifikues. Në vijim të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur në Komision edhe dy kontrata huaje të lidhura mes shtetasit H.Gj. dhe A.D. e M.R.²⁴. Sipas këtyre kontratave, shtetasi H.Gj. ka marrë hua prej secilit prej shtetasve A.D. e M.R. shumat nga 2.000.000 lekë, në vitin 2010, për t'i përdorur si burim për blerjen e këtij apartamenti. Sipas këtyre kontratave, huat janë dhënë në vitin 2010, me një afat shlyerjeje deri në vitin 2025 dhe pa interes.

13.6. Në vlerësimin e Kolegjit, (i) hartimi i këtyre kontratave në vitin 2018, përgjatë procesit të rivlerësimit, (ii) përmbajtja e tyre e cila lidhet me një veprim juridik të pretenduar si të kryer para tetë vitesh, (iii) afati i gjatë i dhënies së huas, (iv) shumat relativisht të larta për t'u huazuar duke konsideruar se huadhënësit nuk rezultojnë të spikasojnë për situata financiare të mira në kushtet e banimit në fshat²⁵, (v) fakti që ajo është dhënë pa interes dhe pa u shpjeguar në asnjë mënyrë arsyet e një marrëdhënieje të tillë dhe, për më tepër, e padokumentuar në kohën reale të ndodhjes së saj, e bëjnë të pabesueshme ekzistencën e këtyre marrëdhënieve dhe të paprovueshëm pretendimin e subjektit se kushëriri i tij ka financuar blerjen e këtij apartamenti edhe me huat e deklaruara si më sipër.

13.7. Kolegji e gjen me vend të nënvizojë në këtë rast natyrën dhe objektin e detyrimit për të provuar burimet e ligjshme të blerjes së kësaj pasurie nga shtetasi H.Gj. si jo të autorizuara drejtpërdrejt nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili ngarkon me këtë detyrim subjektet e rivlerësimit kur ato vetë deklarojnë se si burim i krijimit të pasurive të tyre kanë shërbyer shumat e dhëna hua apo dhuruar prej personave të tretë të lidhur sipas kësaj dispozite, por i autorizuar nga nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, që autorizojnë organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit e kontrollit të pasurisë çdo situatë, fakt apo cilësi, në funksion të realizimit të qëllimit të këtij procesi, autorizim i cili jo detyrimisht lidhet me cilësimin e personave të tretë si persona të tjerë të lidhur²⁶.

²⁴Kontrata e huas e lidhur midis subjektit të rivlerësimit dhe huadhënësit A.D. me nr {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.12.2018.

Kontratën e huas së lidhur midis subjekti të rivlerësimit dhe huadhënësit M.R. nr. {***} rep., nr. {***} kol., e hartuar pranë noterit B.Gj.V., më datë 13.12.2018.

²⁵Referuar anketës së INSTAT për periudhën 2002-2005-2008-2012, për trendin e varfërisë, rezultojnë se ajo është rritur më shumë në zonat rurale se ato urbane:
<http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-s%C3%AB-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-amnj/publikimet/2012/anketa-e-matjes-s%C3%AB-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2012-e-rishikuar/>

²⁶ Kolegji në vendimin nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019, ka arsyetuar:

Në këto rrethana, duke konstatuar gjithashtu se nuk rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit të dhëna apo dyshime që kjo pasuri e depozitë në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit është një pasuri e fshehur e tij, situatë e

13.8. Në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi mundësinë financiare të shtetasit H.Gj. për blerjen me të ardhura nga burime të ligjshme të këtij apartamenti, mbetet një pretendim i paprovuar, i cili e legjitimon më tej Kolegjin të vlerësojë natyrën e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, në drejtim të shqyrtimit të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni se kjo pasuri është një pasuri e fshehur e vetë subjektit të rivlerësimit, qëndrim i ankimuar prej subjektit si i pambështetur në prova.

13.9. Në vijim të kësaj analize, Kolegji konstaton se shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në lidhje me marrëdhënien tij me këtë pasuri, janë kontradiktore e të paarsyeshme, ato nuk bindin për vërtetësinë e deklaratimit të tij se ai ka vetëm të drejta përdorimi mbi këtë apartament, por ngrenë dyshime forta për paraqitjen e rrethanave të rreme, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë me këtë pasuri.

13.10. Së pari, subjekti i rivlerësimit konstatohet se nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përputhje me detyrimin kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, edhe atë ligjor të parashikuar në shtojcën nr. 1 të ligjit nr. 84/2016. Të njëjtin qëndrim subjekti ka mbajtur edhe në përgjigjet e pyetësorit të parë, të dërguar nga Komisioni me nisjen e hetimit administrativ në këtë proces. Ai ka mohuar fillimisht të ketë në përdorim apartamentin në fjalë dhe e ka pohuar përdorimin e tij vetëm në pyetësorët vijues të dërguar prej Komisionit, pasi i është bërë prezent që kjo rrethanë kishte dalë në hetim prej denoncimit publik dhe prej informacioneve të organeve ndihmëse.

13.11. Së dyti, subjekti ka shpjeguar se ai e ka përdorur apartamentin në vitet 2011-2012 si i ftuar i familjes T., pronarë të truallit mbi të cilin është ndërtuar pallati dhe, për pasojë, pronarë të një pjese të apartamenteve, për shkak të një marrëdhënieje të posaçme që ka me ta dhe, më pas, në vitet 2013-2014 e ka përdorur atë i lejuar nga kushëriri i tij H.Gj., i cili e kishte blerë këtë apartament për t'ua lënë fëmijëve. Në vlerësimin e Kolegjit, këto shpjegime të subjektit gjenden të pabesueshme dhe kontradiktore, pasi: nga kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie prej H.Gj. rezulton se kjo pronë i është dorëzuar atij që në vitin 2010, vit në të cilin është bërë edhe pagesa e çmimit prej 9750000 lekësh. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se ai ka përdorur këtë apartament në vitet 2011-2012, mundësuar prej familjes T., bëhet i pabesueshëm pasi në këtë kohë ky apartament, referuar kontratës së shitjes, i kishte kaluar në përdorim blerësit të tij, z. H.Gj., i cili, për më tepër, kishte bërë edhe pagesën e plotë të çmimit. Familja T., referuar akteve²⁷ që ka dorëzuar vetë subjekti i rivlerësimit si provë gjatë seancës dëgjimore, nuk rezultonte të kishte këto të drejta në vitin 2011, për pasojë nuk mund t'ia kalonte ato subjektit.

cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, duke përdorur arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se nëna e subjektit të rivlerësimit është trajtuar si person tjetër i lidhur jo në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, për pasojë, detyrimi që Komisioni i ngarkon subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e depozitës në emër të saj, është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe nuk mund të shërbejë kjo rrethanë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

²⁷ Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, më datë 09.01.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratën noteriale të K.T. nr. {***} rep., e nr {***} kol., të datës 07.01.2019, e cila shpreh se

13.12. Së treti, pavarësisht deklaramëve të subjektit të rivlerësimit se ai e ka përdorur apartamentin sporadikisht, nga kronologjia e fakteve, qoftë edhe atyre të pretenduara prej tij, rezulton se ai ka të drejta përdorimi në këtë pasuri që prej vitit 2011 e në vazhdim, kohë relativisht e gjatë, e cila nuk mund të trajtohet si një përdorim rastësor e i parëndësishëm. Vetë kontrata e huadhënies, e paraqitur prej subjektit si e lidhur me shtetasin H.Gj. për dhënien në përdorim të kësaj pasurie, flet në përmbajtjen e saj për përdorim të vazhdueshëm të kësaj prone prej subjektit të rivlerësimit. Në këtë akt, megjithëse të hartuar përgjatë periudhës që zhvillohej procesi i rivlerësimit²⁸, përsëri nuk pasqyrohet marrëdhënia në modalitet që pretendon subjekti, por si dakordësi për kalimin pa afat të së drejtës së përdorimit mbi këtë apartament subjektit, e pakushtëzuar kjo e drejtë me ndonjë kufizim kohor apo ndonjë kusht tjetër që buron nga e drejta e pronësisë.

13.13. Së katërti, nga hetimi nuk rezulton asnjë e dhënë që vetë shtetasi H.Gj. ta ketë përdorur për veten apo familjen e tij apartamentin në asnjë mënyrë. As vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar ndonjë pretendim të tillë. Sjellja e shtetasit H.Gj. me këtë apartament, të blerë për një vlerë të konsiderueshme, me të cilin nuk duket se ka asnjë marrëdhënie nga ato që burojnë nga e drejta e pronësisë, pasi ai përdoret plotësisht nga subjekti i rivlerësimit, nuk e bind Kolegjin se është sjella e pronarit me sendin në pronësi të tij. Pretendimi i subjektit se ai e përdor apartamentin vetëm për pushime, nuk e ndryshon arsyetimin e mësipërm, konsideruar faktin se apartamenti gjendet në zonën e plazhit dhe duket se destinacioni i tij kryesor është përdorimi për këtë sezon, përveç se për banim të përhershëm.

13.14. Në përfundim të analizës së mësipërme, duke analizuar faktin e mungesës së burimeve të ligjshme për të blerë këtë pasuri prej shtetasit H.Gj. dhe gjithë sjelljen e subjektit në raport me procesin e rivlerësimit dhe fakteve që kanë rezultuar nga hetimi, Kolegji arrin në përfundimin se kjo pasuri është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe se ai është përpjekur fillimisht të mos ta deklarojë atë dhe më pas të deformat faktet që tregojnë natyrën e marrëdhënies së tij me këtë pasuri, duke u gjendur në këtë mënyrë para parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84.2016, që lidhen me fshehjen e pasurisë.

- 14.** Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë me mosdeklarimin e pjesës në bashkëpronësi të bashkëshortes së tij në një apartament të ndodhur në Bulqizë, duke konkluduar se pretendimi i subjektit është i drejtë për sa i përket kualifikimit ligjor të faktit.

14.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ka në bashkëpronësi me persona të tjerë {***} pjesë takuese të një apartamenti me sipërfaqe 83 m², të ndodhur në Bulqizë, me nr. pasurie {***}. Këtë apartament, bazuar në

si përfaqësuese përkatëse me të drejta të karakterit absolut administrues të pronës, në ushtrim të kompetencave të saj, i ka lënë në përdorim subjektit të rivlerësimit një apartament.

²⁸ *Kontratë huapërdorje, e lidhur midis huadhënësit H.Gj. dhe huamarrësit Alfred Gjoni, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 23.12.2018.*

kartelën e pasurisë, e ka përfituar me trashëgimi më datë 23.03.2015²⁹. Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *vetting*, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në këtë deklaratë pjesën takuese të bashkëshortes së tij mbi këtë apartament.

14.2 Kolegji vlerëson ashtu si edhe Komisioni se personi i lidhur me subjektin kishte detyrimin, në zbatim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe parashikimeve të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, të deklaronte marrëdhënien e pronësisë me këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj. Gjithashtu subjekti e kishte pasur këtë detyrim edhe në zbatim të parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Fakti që personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit nuk e ka zbatuar këtë detyrim ligjor, e bën deklaratën e pasurisë *vetting* të pasaktë në drejtim të deklarimeve të saj dhe në zbatimin *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit nën parashikimin e kësaj pike.

14.3 Pavarësisht nga ky konkluzion, Kolegji çmon se nuk qëndron konkluzioni i Komisionit për të konsideruar këtë pasaktësi si fshehje të pasurisë, për sa kohë mosdeklarimi i kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk rezulton të jetë i lidhur me ndonjë përpjekje për të fshehur këtë pasuri, për shkak të mosjustifikimit të burimit të saj. Sipas akteve që ndodhen në dosje, nuk rezulton të jenë ngritur në asnjë moment çështje apo dyshime mbi ligjshmërinë e fitimit të kësaj pasurie prej pronarëve origjinarë të saj, dhe konsideruar edhe pjesën takuese të personit të lidhur, prej {***} të një apartamenti prej 82 m² të ndodhur në Bulqizë, aq më shumë zbehet mundësia për të fshehur ndonjë burim të paligjshëm. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se nuk plotësohet kushti kushtetues i parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, që të mbështesë parashikimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 për ta konsideruar këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit si fshehje pasurie, por mbetet vetëm konstatimi i një pasaktësie në plotësimin e deklaratës *vetting*, sipas interpretimit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

- 15.** Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e parashtruar në ankim nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit ai kundërshton qëndrimin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin e së drejtës së përdorimit të tri automjeteve që janë përdorur prej tij, e cila është konsideruar si një shkelje e ligjit e lidhur me fshehjen e pasurisë.

15.1 Nga shqyrtimi i këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se Komisioni ka konkluduar se fakti që subjekti ka deklaruar përdorimin e tri automjeteve vetëm pas përgjigjeve të dhëna në pyetësonin standard dhe jo në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka vendosur atë në kushtet e fshehjes së pasurisë në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 11, 30, 31, 32 e 33, si dhe të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

15.2. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikull, rezulton që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të drejta përdorimi mbi tri automjete, të cilat nga hetimi kanë rezultuar se përdoren prej tij. Ai ka deklaruar për herë të parë marrëdhënien me këto automjete vetëm në përgjigje të pyetjeve të dërguara nga Komisioni me pyetësonin e parë standard, me të cilin nis

²⁹ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 14.02.2018, të ZVRPP-së Bulqizë.

procedura administrative në Komision. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar shpjegime/informacion shtesë subjektit të rivlerësimit rreth përgjigjeve të dhëna prej tij në pyetësorin e datës 05.02.2018, në të cilin është deklaruar përdorimi i 3 (tre) makinave. Në përgjigje të kësaj pyetjeje të Komisionit, subjekti është shprehur se: *nuk kam pasur asnjëherë në përdorim të njëkohshëm 3 (tri) automjete, përgjigjja nënkuptonte për sa memoria lejon, tri raste gjithsej në të paktën 15 vite, prej kohës që kam marrë leje drejtimi, ku unë kam huazuar për përdorim automjet.*

15.3. Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka në përdorim tri automjete, bazuar në kontratat e huapërdorjes lidhur mes tij dhe pronarëve të këtyre automjeteve, të identifikuar si më poshtë.

- Automjetin tip “Audi Q 7”, me targa {***}, marrë në përdorim me kontratë huapërdorimi nr. {***}, datë 18.08.2014, nga z. A.D., për një afat të pacaktuar, me të drejtë për të qarkulluar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë
- Automjetin, tip “Mercedes Benz 204” (C 220 CDI), me targa {***}, marrë në përdorim me kontratë huapërdorimi nr. {***}, datë 01.10.2014, nga z. I.Sh., për një afat të pacaktuar, me të drejtë për të qarkulluar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.
- Automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targa {***}, marrë në përdorim me kontratë huapërdorimi nr. {***}, datë 12.11.2015, nga z. E.Ç., për një afat të pacaktuar, me të drejtë për të qarkulluar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

15.4. Në ankim subjekti ka pretenduar se automjetet ai i ka përdorur për periudha të shkurtra dhe sporadike, kryesisht për udhëtime jashtë vendit dhe se kontratat ekzistojnë si një nevojë për pasjen e një dokumentacioni që legjitimonte lëvizjen e tij, por ato nuk përfaqësojnë përmbajtjen reale të marrëdhënies, prandaj dhe mosdeklarimi në deklaratën *vetting* përbën vetëm një harresë njerëzore. Kolegji, në këndvështrim të kësaj situate faktike, çmon të rëndësishme të veçojë disa rrethana që e përcaktojnë qëndrimin e tij në lidhje me këtë pretendim. Së pari, Kolegji vëren se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këto automjete, sende të luajtshme në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil dhe të ligjit nr. 84/2016, është një marrëdhënie juridiko civile e huapërdorjes, e rregulluar shprehimisht nëpërmjet tri kontratave të sipërcituara, të paraqitura me cilësinë e provës në hetim prej vetë subjektit të rivlerësimit. Në analizë të këtyre veprimeve juridike, rezulton se subjekti ka fituar prej tyre të drejta përdorimi mbi këto sende, sipas parashikimeve të nenit 901 të Kodit Civil. Këto të drejta janë gëzuar realisht prej subjektit, sipas pohimeve të vetë atij, dhe janë ende efektive sipas përcaktimeve të kontratave të sipërcituara dhe në mungesë të shfaqjes së ndonjë vullneti të ndryshëm të palëve, që i jep fund kohëzgjatjes së këtyre marrëdhënieve.

15.5. Së dyti, shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016 ngarkon subjektet e rivlerësimit me detyrimin për të deklaruar të drejtat e përdorimit mbi sende të paluajtshme e të luajtshme, detyrim të cilin subjekti i rivlerësimit e ka shkelur me mosdeklarimin e këtyre të drejtave në deklaratën e pasurisë *vetting*.

15.6. Së treti, Kolegji çmon se mosdeklarimi i disa rrethanave të tilla nuk është një harresë njerëzore, por një sjellje e qëllimshme e subjektit për të mos paraqitur me vërtetësi marrëdhëniet

e tij të përdorimit me këto sende, në funksion të shmangies së kontrollit nga organet e rivlerësimit të këtyre pasurive. Në këtë vlerësim, Kolegji mban parasysh që nuk është konsideruar në të njëjtën mënyrë përdorimi sporadik prej subjektit të rivlerësimit i një automjeti në pronësi të avokatit I.D. dhe L.N., pikërisht sepse në vlerësimin e Komisionit, por edhe të Kolegjit, përdorimi në një rast të vetëm apo të veçuar të një sendi nuk duhet të barazohet me të drejtat e përdorimit mbi sendet, siç është rasti i përshkruar më lart.

15.7. Mbështetur në këtë arsyetim, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka deklaruar të drejtën e përdorimit mbi këto sende, duke u gjendur në këtë mënyrë para parashikimit ligjor të fshehjes së pasurisë, e cila përfshin edhe fshehjen e së drejtës së përdorimit të një pasurie, sipas nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84.2016.

15.8. Në konkluzion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë, Kolegji çmon se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, gjerat “b”, “c” e “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili e vë atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin ndaj tij të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Ç. *Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.*

- 16 Në ankim, lidhur me konkluzionet e Komisionit për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk mund të konsiderohet si shkak shkarkimi vonesa në trajtimin e çështjeve dhe arsyetimin e vendimeve, pasi kjo duhet parë e vlerësuar në raport me ngarkesën e punës së subjektit të rivlerësimit, si dhe duke konsideruar se edhe vetë Komisioni në arsyetimin e vendimit objekt ankimi nr. 100, datë 14.01.2019, ka tejkaluar afatin ligjor 1-mujor të parashikuar për arsyetimin e tij.

16.1 Në vendimin e Komisionit, lidhur me kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, është konkluduar: [...] *Komisioni çmon se të metat e konstatuara në shqyrtimin dosjeve gjyqësore të trajtuara më sipër, reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen, zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, mënyra jo korrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

16.2 Lidhur me këtë pretendim të subjektit, Kolegji analizoi faktet që rezultojnë nga dosjet gjyqësore të shqyrtuara prej Komisionit në lidhje me verifikimin e aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit dhe ndikimin që këto zgjatje kanë pasur në të drejtat e palëve në proceset gjyqësore përkatëse, pasi i vlerësoi ato, arriti në konkluzionin se me të drejtë Komisioni i ka cilësuar këto gjetje si elemente që tregojnë e flasin për dobësi në aftësinë organizative të subjektit, në kuptim të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Në këtë kontekst, Kolegji konstatoi se

tejkalimi i afateve të gjykimit në mënyrë të përsëritur në çështjet e shqyrtuara³⁰, kohëzgjatja e gjykimit të tyre tej edhe një afati të arsyeshëm të një gjykimi referuar objektit të gjykimit, fakti që kjo situatë dukshëm lidhet me sjelljen apo mungesën e aftësisë së subjektit të rivlerësimit për të kontrolluar e administruar proceset gjyqësore (shtyrja e seancave disa herë për avokat, dhënia e kohës organit të akuzës për të depozituar fashikullin, mospagurimi i prezencës së palëve në gjykim apo moszbatimi me korrektësi i dispozitave procedurale që sigurojnë e rregullojnë gjykimin në mungesë), fakti që kjo sjellje ka qenë e përsëritur duke i zgjatur dukshëm deri në zvarritje proceset gjyqësore e ka provokuar ankesa të shumta të palëve ndërgjyqëse në KLD, e çojnë Kolegjin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur në drejtim të këtij indikatorit të aftësive profesionale, në përgjithësi e në mënyrë të vazhdueshme, defekte të rëndësishme që e afektojnë negativisht vlerësimin e kriterit të aftësive të tij profesionale dhe e bëjnë të pambështetur pretendimin e tij kundrejt qëndrimit të mbajtur prej Komisionit në këtë drejtim.

16.3 Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit lidhur me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për çështjen që i përket të gjykuarit G.D., sipas të cilit: *Arsyetimi i Komisionit lidhur me cilësimin e gabuar të çështjes me të pandehur shtetasin G. D. dhe lidhja që trupi gjykues i Komisionit i ka bërë kësaj çështjeje me pyetjet e shtruara në seancën dëgjimore publike, e përgjigjet e dhëna, është absolutisht irracionale dhe joligjore.*

16.4 Në funksion të shqyrtimit të këtij pretendimi, Kolegji analizoi qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për këtë çështje, në këndvështrim të rrethanave të faktit, por edhe të kuadrit ligjor në fuqi. Nga aktet e administruara në fashikull dhe të vendimit objekt shqyrtimi, për këtë çështje rezulton që Komisioni është shprehur:

Në pjesën arsyetuese të vendimit konstatohet mungesa e argumentimit të konkluzionit që veprimet e të pandehurit të plotësojnë elementet e veprës penale të “Plagosjes së rëndë me dashje”, si edhe analizimi i këtyre elementeve, të cilat në të gjitha vendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit pasqyrohen qoftë edhe në formë të shkurtuar [...] pra gjykata, në ndryshimin e kualifikimit të veprës penale, duhej të argumentonte se ç’motiv pati i pandehuri për të qëlluar në

³⁰ Në vendimin e Komisionit nr. 100, datë 14.01.2019, janë evidentuar 5 (pesë) çështje për të cilat është konstatuar se gjykimi i tyre ka zgjatur përtej afatit të përcaktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. {***}, datë 14.04.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, për të cilat ka rezultuar se:

- Për çështjen e të pandehurit N.Gj., gjykimi ka zgjatur 1 vit, 8 muaj e 9 ditë, në tejkalim të afatit standard 1-vjeçar, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.
- Për çështjen e të paditurës K.Gj. kundër të paditurve T. e P. P., gjykimi ka zgjatur 9 muaj e 11 ditë, duke tejkaluar standardin kohor prej 6 muajsh, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.
- Për çështjen e paditësit N. G. etj. kundër OSHEE Tiranë, gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit, 7 muaj e 23 ditë, në intervalin kohor 11.02.2015 – 03.10.2016, duke tejkaluar dukshëm afatin standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Rivlerësimit.
- Nga të dhënat arkivore të KLD-së, Komisioni ka evidentuar se nga subjekti i rivlerësimit është zvarritur me më shumë se 2 vjet çështja me palë paditëse D.Sh. etj. dhe palë të paditur ZRPP-në Kurbin. Për këtë çështje, inspektorët e ILKD-së deklarojnë se: “Çmohet e pajustificuar mbajtja dy vjet e çështjes së pezulluar për të përfunduar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, proces që nuk ka arsye të zgjasë më shumë se tre muaj. Gjyqtari ka shfaqur neglizhencë në organizimin e punës dhe kjo është bërë shkak për zvarritjen e gjykimit”.
- Në lidhje me ankesën pranë Komisionit të Xh.J., Komisioni ka evidentuar zvarritje të procesit gjyqësor, duke u shprehur se: “Gjykimi është zvarritur për shkak të sjelljes së palëve dhe organizimit jo të mirë të punës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Katër seanca janë shtyrë për t’i dhënë mundësi palës të mbrohet me avokat. Dy seanca janë shtyrë për t’i dhënë kohë avokatit të njihet me dosjen, ndërkohë në vendim rezulton se ankuesja nuk është përfaqësuar me avokat”.

drejtim të viktimës, pa pasur një konflikt midis atyre të atypëratyshëm, që mund të çonte në konkluzionin e plagosjes me dashje.

Komisioni gjithashtu në vendimin e tij ka përmendur edhe faktin se subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e dhënë për pyetjen e vëzhguesit ndërkombëtar në seancë dëgjimore për kualifikimin ligjor të rrethanave të faktit të paraqitura prej tij, të cilat janë të ngjashme me ato të çështjes që i përkiste të gjykuarit G.D., ka dhënë një kualifikim të ndryshëm ligjor nga ai që ka mbajtur si në vendimin që lidhet me çështjen e analizuar prej Komisionit.

16.5 Kolegji, duke shqyrtuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, konstaton së pari se subjekti kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni në drejtim të analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të manifestuara në gjykimin dhe arsyetimin e vendimit nr. 94, datë 20.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që i përket të gjykuarit G.D. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se i gjykuari është akuzuar dhe dënuar me vendime të mëparshme të gjykatave shqiptare për veprën penale të “vrasjes me paramendim”, të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal. Pas ekstradimit të tij nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe rishikimit të vendimit gjyqësor të dënimit të tij, ai është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, pjesë e trupit gjykues në të cilin ka qenë edhe subjekti, dhe në përfundim të gjykimit gjykata ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale nga ajo e “Vrasjes me paramendim”, të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal në atë të “Plagosjes së rëndë me dashje me pasojë vdekjen”, parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal. Për shkak të këtij kualifikimi i të ri, i gjykuari është dënuar me një masë dënimi më të ulët se ajo e mëparshme, në zbatim të dispozitës përkatëse.

16.6 Kolegji, pas shqyrtimit të përmbajtjes së vendimit në këndvështrim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se me të drejtë Komisioni ka konkluduar për mungesë të arsyetimit ligjor në lidhje me ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale për të cilën është gjykuar i pandehuri D.

Në pjesën arsyetuese të vendimit, Kolegji vëren mangësi në analizën dhe argumentimin e qëndrimit të gjykatës për të ndryshuar cilësimin ligjor të veprimeve kriminale të të gjykuarit, nga vrasje me paramendim te plagosje me pasojë vdekjen e viktimës. Gjykata në këto raste ka detyrimin të arsyetojë e shpjegojë bindshëm arsyet që e çojnë atë drejt një vendimmarrjeje të caktuar, aq më shumë kur kjo vendimmarrje është thelbësisht e ndryshme nga ajo e gjykatave të mëparshme, të shprehura me vendime gjyqësore të formës së prerë. Në vendim nuk gjendet analizë e të gjitha fakteve që kanë rezultuar prej gjykimit të çështjes, por potencohet dhe përdoret si me vlerë të veçantë një rrethanë e çmuar prej gjykatës, ajo e mungesës së konfliktit të viktimës me të gjykuarin, si thelbësore dhe me një vlerë të paracaktuar kundrejt provave të tjera. Kolegji konstaton se në arsyetimin e vendimit që i përket kësaj çështjeje, gjykata nuk ka çmuar dhe analizuar provat dhe vlerën e tyre konform parashikimit të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos arsyetuar në mënyrë të kuptueshme, të logjikshme e ligjore pse gjykata ka konkluduar në mënyrë të ndryshme për anën subjektive të veprës penale, dhe se si kjo anë subjektive është e lidhur dhe e reflektuar dhe përlligj njëkohësisht anën objektive të veprës në rastin konkret.

16.7 Duke pasur në konsideratë se Kolegji nuk është një gjykatë më e lartë në kuptim të vlerësimit të korrektesisë së vendimmarrjes dhe zgjidhjes së themelit të çështjeve të trajtuara prej subjekteve të rivlerësimit, por për llogari të funksionit kushtetues të vlerësimit të aftësive të tyre

profesionale, vlerëson se në analizën që i bëhet indikatorit të “grykimit të dobët”, sipas parashikimit kushtetues të nenit E, paragrafi 4 i Aneksit të Kushtetutës³¹ dhe të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016³², duhet të kihet në konsideratë dy elementet përbërëse të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016³³, përkatësisht njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor. Pikërisht për shkak të këtij kualifikimi dhe parashikimit të paragrafit të katërt të kësaj dispozite, aftësitë gjyqësore/grykimi i magjistratit do të kryhen mbi bazën e vlerësimit të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, pa grykuar korrektësinë e vendimmarrjes.

16.8 Referuar rastit konkret, Kolegji vlerëson se arsyetimi ligjor i dhënë në këtë rast nga grykatarja, për ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale, është i një cilësie të dobët dhe në kushtet e mungesës së një argumentimi logjik. Ky vlerësim të çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit demonstroi në këto rrethana mungesë të theksuar të aftësive profesionale të gryqtarit, në drejtim të arsyetimit ligjor në çështjen konkrete, duke qenë se është shmangur nga arsyetimi, zbatimi i normës procedurale që orienton grykatën në vlerësimin e rrethanave të faktit në harmoni e raport me njëra-tjetrën, tregues që lidhet me nivelin e cilësisë së analizës e argumentimit logjik, sipas kuptimit të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016. Në këtë mënyrë, Kolegji arsyeton se subjekti i rivlerësimit, për shkak të mangësive serioze në drejtim të këtij indikatorit, arsyetimit ligjor, dhe peshën që ai ka në vlerësimin e aftësive profesionale të magjistratit, vlerësohet se ka pasur një grykim të dobët në trajtimin e çështjes ligjore konkrete, në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe në kuptim të dispozitave që vlerësojnë kriterin e aftësive profesionale në ligjin nr. 84/2016.

16.9 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka qenë në këtë vendim gryqtari kryesues i çështjes dhe nuk përgjigjet për këtë vendimmarrje të marrë madje nga një grykatë tjetër nga ajo ku ai ushtronte funksionet, nuk e zhvesh atë nga përgjegjësia për marrjen e vendimeve të arsyetuara e të argumentuara dhe as nga përgjegjësia e shprehjes në mënyrë të qartë, të kuptueshme e të logjikshme të të gjitha arsyeve që e çojnë grykatën drejt një vendimmarrjeje të caktuar. Arsyetimi i një vendimi gjyqësor, ndër të tjera, është një mekanizëm kontrollues

³¹ Neni E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “ Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, grykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën ”.

³² Ligji nr. 84/2016 në neni 44 parashikon: “Relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gryqtarëve ose prokurorëve dhe aktet e tjera ligjore. Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë: [...] c) “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, grykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës ”.

³³ Neni 72, “Aftësitë profesionale të gryqtarit”, i ligjit nr. 96/2016 parashikon se: “1. Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të gryqtarit vlerësohet aftësia profesionale e gryqtarit në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gryqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsyetimit ligjor të gryqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë, si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik. 4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa grykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gryqtarit që vlerësohet. ”

vetëpërgjegjshmërie i veprimtarisë gjyqësore, është një mjet nëpërmjet të cilit jo vetëm palët, por edhe institucionet, apo publiku, të kuptojnë, kontrollojnë e vlerësojnë veprimtarinë gjyqësore të një gjykate.

Gjithashtu, Kolegji vëren se përgjigjet e dhëna nga subjekti kundrejt pyetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, për një situatë ligjore pothuaj të njëjtë me rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi, janë krejtësisht të ndryshme nga ato që subjekti ka mbajtur në vendimin gjyqësor. Në vlerësimin e Kolegjit, ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit demonstroi inkoherencë në drejtim të zbatimit të ligjit në mënyrë të njëjtë e të barabartë për çdo rast e çdo individ, i cili në rast të një hetimi të thelluar, mund të shihej potencialisht edhe si një problematikë që lidhej me paanësinë e mungesën e mundshme të integritetit të tij në gjykimin e një çështjeje, në kuptim të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

16.10 Në konkluzion të vlerësimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e aftësive profesionale, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi serioze të indikatorit të arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, dhe njëkohësisht mangësi të theksuara në aftësitë e tij organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Këto konkluzione, duke qenë se lidhen me kriteret e vlerësimit të magjistratëve sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, kritere të cilat urdhërohen të përdoren nga organet e rivlerësimit edhe për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, e çojnë Kolegjin në të njëjtin përfundim me Komisionin se subjekti i rivlerësimit, për shkak të këtyre mangësive në indikatorët e kriterit të aftësisë profesionale, sipas parashikimeve të Nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, gjatë ushtrimit të profesionit ka demonstruar gjykim të dobët që ka sjellë gjithashtu shkelje të të drejtave të palëve në proceset gjyqësore të trajtuara prej tij, në nivel të tillë që shihen të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Për të gjitha sa arsyetohet më lart, subjekti konsiderohet se është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit dhe se ndaj tij duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

D. Shkaqet e ankimit që lidhen me cenimin e besimit të publikut te drejtësia

17. Në ankim kundër qëndrimit të mbajtur nga vendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka pretenduar se konkluzioni i vendimit të Komisionit për cenim të besimit të publikut, është i pabazuar, pasi arritja e një konkluzioni të tillë duhet të jetë detyruesisht e lidhur me veprime apo sjellje që konsiderohen se përbëjnë shkelje të normave ligjore në fuqi. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe konkluzioneve të arritura prej Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, Kolegji, duke analizuar të gjithë situatën faktike, gjetjet e Komisionit përgjatë procedurës administrative të rivlerësimit të zhvilluar pranë tij, sjelljen e subjektit të rivlerësimit, e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, por duke përdorur një arsytim të ndryshëm dhe duke bërë një cilësim të ndryshëm të fakteve të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

17.1 Kolegji çmon të nënvizojë faktin se e mbështet të drejtën e tij për një cilësim të saktë të fakteve, në zbatimin e parimit gjyqësor të parashikuar në nenin 16, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon: *Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat*

ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Gjithashtu Kolegji vëren kryesisht se të gjitha faktet, të cilat iu nënshtruan vlerësimit të këtij trupi gjykues për çështjen në fjalë, ishin fakte për të cilat subjekti i rivlerësimit ishte njoftuar nga Komisioni se ishin konsideruar shkelje të ligjit dhe për të cilat subjektit i ishte kaluar barra e provës, në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016³⁴. Për më tepër, këto fakte janë bërë pjesë e arsyetimit dhe konkluzioneve të Komisionit, të pozicionuara në pjesë të caktuara të vendimit dhe të lidhura me pasuri apo sjellje të caktuara të subjektit të rivlerësimit. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha mundësitë të mbrohet, t'i kundërshtojë ato, qoftë përgjatë procesit administrativ, qoftë nëpërmjet ankimit të paraqitur në Kolegji, duke realizuar të drejtën e tij kushtetuese të mbrojtjes e ushtrimit të një ankimi efektiv, në kuptim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, sipas parashikimeve të neneve 42 e 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 6 e 13 të KEDNj-së.

17.2 Në ndryshim nga Komisioni, Kolegji vlerëson se faktet e përmendura në vendim si deklarime të rreme të subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit administrativ, duhet të analizohen së bashku në kuptim të vlerësimit tërësor të sjelljes së subjektit të rivlerësimit përgjatë procesit të rivlerësimit dhe se, në analizë të integruar të tyre, duhet të arrihet në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje besimin e publikut të një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sigurtë jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të tij përgjatë këtij procesi.

17.3 Në funksion të kësaj analize, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ, duke iu përgjigjur në mënyra të ndryshme pyetjeve të njëjta të drejtuara nga Komisioni për çështje të caktuara, për të cilat është kërkuar një shpjegim prej tij.

17.4 Në këtë kontekst, konstatohen kundërshtitë e mëposhtme.

Sipas akteve të administruara gjatë hetimit, ka rezultuar se familjarët e subjektit kanë lidhur kontratat për shitjen e pasurisë me të dhënat e mëposhtme.

- i. Kontratë nr. {***}, datë 06.02.1997, sipas së cilës shitësit A. dhe N.Gj. kanë shitur një lokal me sip. 21,8 m², në shumën 600.000 lekë.
- ii. Kontratë nr. {***}, datë 22.06.2001, sipas së cilës, është shitur apartamenti me sip. 63,7 m², në shumën 500.000 lekë.
- iii. Kontratë shitblerje toke nr. {***}, datë 02.02.2002, sipas së cilës shitësi N.Gj. ka shitur tokë arë me sip. 10.517 m², në shumën 500.000 lekë.

17.5 Në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Komisioni për burimin e të ardhurave që, sipas pretendimit të tij, kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 500.000 lekësh, të huazuar atij prej familjarëve, subjekti është përgjigjur se ato janë krijuar prej:

- i. shitjes së dyqanit në vitin 1997, në shumën 1.000.000 lekë, përkundër shumës prej 600.000 lekësh, referuar kontratës nr. {***}, datë 06.02.1997, për shitjen e këtij objekti;
- ii. shitjes së tokës prej 10.000 m², në shumën 1.000.000 lekë, përkundër shumës prej 500.000 lekësh, referuar kontratës nr. {***}, datë 22.06.2001, për shitjen e këtij objekti;

³⁴ Rezultatet e hetimit paraprak të Komisionit i janë përcjellë subjektit të rivlerësimit më datë 27.11.2018.

iii. shitjes së banesës (2+1) në shumën 1.500.000 lekë³⁵, përkundër shumës prej 500.000 lekësh, referuar kontratës nr. {***}, datë 02.02.2002, për shitjen e këtij objekti.

17.6 Në lidhje me mobilimin e apartamentit në Tiranë, subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard ka deklaruar se vlera e tij është në shumën 7.000 euro. Në lidhje me këtë vlerë, i është kërkuar subjektit të rivlerësimit të deklarojë shpenzimet e kryera në vite në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti. Ai ka deklaruar se nuk e mban mend. Është ripyetur sërish subjekti i rivlerësimit dhe në përgjigjet e datës 19.10.2018, ai ka deklaruar:

Shpenzimet janë kryer si më poshtë:

vlera 50.000 lekë, kursime nga paga, periudha 2002-2004; vlera 50.000 lekë, kursime nga paga, periudha 2005-2006; vlera 200.000 lekë, kursime nga paga, periudha 2007-2009; vlera 300.000 lekë, kursime nga paga, për vitet 2010-2012.

Ndërkohë, në vijim të procesit të rivlerësimit në Komision, më datë 30.10.2018, ai ka kryer deklarime të ndryshme për shumën dhe kohën e kryerjes së mobilimit të shtëpisë, duke deklaruar se në vitin 2001 ka shpenzuar për mobilimin e këtij apartamenti shumën 120.000 lekë.

17.7 Në lidhje me shtesën e apartamentit me sipërfaqe 47 m², ka rezultuar se përveç kundërshtive mes deklarimeve të kryera në deklaratën *vetting* për kohën e ndërtimit të saj, për të cilën është konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të rremë, edhe përgjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me kohën e ndërtimit të saj, duke e ndryshuar atë disa herë. Konstatohet se ai ka deklaruar, pasi është ripyetur për të sqaruar kohën e ndërtimit të kësaj shtese, se: *Pjesa e parë e shtesës është përfunduar në vitin 2004, ndërsa pjesa tjetër me sip. 24,74 m², është përfunduar në vitin 2006 pjesërisht dhe përfundimisht në vitin 2009.* Edhe ky deklarim i subjektit të rivlerësimit nuk është i saktë pasi, bazuar në dokumentacionin e administruar, shtesa ka përfunduar minimalisht në vitin 2007, kohë kur rezulton të jetë bërë oponenca teknike për këtë shtesë, e cila i është dërguar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 05.09.2007. Gjithashtu, nga ana e subjektit të rivlerësimit, për këtë pasuri, nuk rezulton të ketë deklarim në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2009.

17.8 Në lidhje me të dhënat e përgjigjet e pyetësorit standard dhe shpjegimet e dhëna për të dhënat që kanë rezultuar nga sistemi TIMS, kanë rezultuar kundërshti si në vijim.

Subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard ka deklaruar se ai, në periudhën 05.08.2013 - 12.08.2013, dhe bashkëshortja e tij, në periudhën 27.07.2013 - 10.08.2013, kanë qenë në Bruksel te kushërinjtë e ish-shoferit të gjykatës, z. Sh.Ç., ndërsa në pyetësonin e dytë në lidhje me këtë udhëtim ai ka ndryshuar deklarim duke thënë se kanë qenë në Prishtinë. Ndërkohë, nga verifikimi i vulave të hyrjes dhe daljes në pasaportën e tij, ka rezultuar se deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk përputhen me të dhënat që gjejnë pasqyrim në pasaportën e tij, por dhe të sistemit TIMS³⁶, të dhëna të cilat tregojnë fakte të ndryshme nga ato që deklaroi subjekti.

³⁵ Në përgjigjet e pyetësorit shtesë të datës 10.09.2018, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pasurinë, apartament 65 m² në Tiranë, e ka blerë si rezultat i shitjes së pronave në qytetin e Laçit (tokë, shtëpi dhe lokal).

³⁶ Në faqen 7 ka **vulë hyrje**, më datë **06.08.2013**, në pikën kufitare hyrëse Karasoviçi, Kroaci.

Në faqen 10 ka **vulë hyrje**, më datë 06.08.2013, në pikën kufitare hyrëse Krk, Kroaci.

Në faqen 9 ka **vulë hyrje**, më datë 06.08.2013, në pikën kufitare hyrëse Obrezje, Slloveni.

Në faqen 13 ka **vulë dalje**, më datë **11.08.2013**, nga Aeroporti i Brukselit.

Nga sistemi TIMS rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dalë më datë 05.08.2013 nga pika kufitare e Hanit të Hotit dhe ka hyrë më datë 12.08.2013, nëpërmjet Rinasit, nga Brukseli, më datë 12.08.2013, ora 00:01.

17.9 Në lidhje me marrëdhëniet e subjektit me shtetasin L.N., subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me përdorimin e automjetit të tij, si dhe nëse kishte gjykuar ndonjë çështje me palë këtë individ. Më datë 19.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me z. L.N. ka lidhje shoqërore pasi ka qenë komshi dhe se nuk ka gjykuar asnjë çështje ku ky shtetas të ketë qenë palë. Ndërkohë, më datë 30.10.2018, pasi Komisioni i ka prezantuar gjetjet sipas të cilave ai kishte gjykuar çështje gjyqësore në lidhje me këtë shtetas, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarin duke u përgjigjur: *Në lidhje me çështjet me palë z. L.N., ato datojnë në vitin 2007 dhe janë të një natyrë tërësisht konstatuese dhe roli i gjyqtarit është tërësisht i pandikueshëm nga çdo lloj interesi subjektiv të palës e për më tepër datojnë një vit para marrjes në përdorim të automjetit.*

17.10 Në lidhje me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me av. I.D., për të cilin është pyetur pasi ka rezultuar nga të dhënat e sistemit TIMS se më datë 09.10.2013, ka përdorur automjetin me targa {***}, në pronësi të këtij individ, ai ka deklaruar se automjetin ia ka marrë avokatit I.D., për një problem të tij në lidhje me shkollimin në Kosovë. Këtë person e ka takuar rastësisht dhe ia ka marrë mjetin në përdorim. Ai deklaroi se nuk i kujtohet të ketë pasur çështje pranë gjykatës së tij apo aq më shumë pranë tij si gjyqtar.

Ndërkohë, në përgjigjet e datës 30.10.2018, pas prezantimit të gjetjeve nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarin duke u përgjigjur se: *Çështja me palë z. I.D. [i referohet çështjes së G.D.] është e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Burrel, ku unë kam qenë anëtar i trupës gjyqësore i deleguar [...].*

17.11 Të gjitha faktet e mësipërme, janë konstatuar prej Komisionit dhe i janë kundërdrejtuar subjektit të rivlerësimit, duke i kaluar atij barrën e provës për të provuar të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit për kontradiktoritetin e konstatuar në deklarime. Nga përgjigjet e dhëna prej tij, por edhe nga shpjegimet e parashtrimit që përmban ankimi i subjektit, nuk rezultoi që ai të ketë dhënë ndonjë shpjegim bindës apo justifikues për këto kundërshti, duke mbetur në këtë kontekst e njëjta situatë faktike për t'u vlerësuar prej Kolegjit.

Ajo që konstatohet lehtësisht nga analiza e këtyre kundërshtive, është se ato kanë ardhur e janë kryer për shkak të vështirësisë së subjektit të rivlerësimit për t'u përballur e provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, të dala nga hetimi administrativ, e janë një përpyetjeje e tij për të prezantuar para organeve të rivlerësimit një situatë faktike që nuk i përgjigjet të vërtetës e që tenton ta deformojë atë në funksion të prodhimit të të dhënave që do të favorizonin subjektin përgjatë procedurës së rivlerësimit.

Mënyra se si subjekti i rivlerësimit u është përgjigjur pyetjeve të Komisionit e ka bashkëpunuar me të gjatë procesit, duket se ka vënë në vështirësi organet për zhvillimin e një procesi efikas, të shpejtë e transparent që bie ndesh me detyrimin ligjor që buron nga neni 48 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit gjatë procesit është një faktor që konsiderohet në vetë zbatimin ose jo të konkluzioneve për këtë proces, aq sa vetë Komisioni e ka nënvizuar këtë mungesë bashkëpunimi në vendimin e tij.

17.12 Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, nuk ka qenë bashkëpunuese dhe, si e tillë, e ka vështirësuar punën e vetë organeve në kryerjen e procesit të rivlerësimit. Kundërshtitë në deklarinimet e subjektit gjatë procesit, konstatohen se kanë qenë një mënyrë sjelljeje e qëllimite, e cila ka synuar të manipulojë të vërtetën, në kundërshtim me detyrimin ligjor që kanë subjektet për të qenë të vërtetë e të saktë përgjatë këtij procesi.

Kolegji çmon se kjo sjellje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit arrihet në konkluzionin se një sjellje e tillë ndaj një procesi kaq të rëndësishëm jo vetëm për jetën

profesionale të subjekteve, por edhe të mirëfunksionimit të vetë sistemit të drejtësisë e shtetit të së drejtës në vend, cenon besimin e publikut te funksionari që e kryen atë, në një mënyrë të parikuperueshme nëpërmjet ndonjë programi trajnimi në Shkollën e Magjistraturës.

17.13 Në këndvështrimin e Kolegjit, edhe vetëm kjo qasje e sjellje ndaj procesit të rivlerësimit, do të përmbushte një nga kushtet e parashikuara për shkarkim nga detyra, atë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, prandaj, ndonëse me një arsyetim të ndryshëm, e gjen të drejtë vendimin e Komisionit edhe për konkluzionin e tij se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

18. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji mbështetur në konkluzionet e mësipërme lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, kontrollin e kriterit të aftësive profesionale e vlerësimin tërësor të procedurave të rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit Alfred Gjoni gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit D dhe pika 4 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nga pikat 3, 4 e 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 100, datë 14.01.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që e ka shkarkuar atë nga detyra, është i drejtë, i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 100, datë 14.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Alfred Gjoni.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 26.06.2020

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi